


THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 15 / vjeshtë 2018

Editorial <i>Gëzim Spahija</i>	2
Bashkësi të Vogla me një Pajisje Mbinatyrore për një Mision të Madh <i>Fatjon Kadiu</i>	3
Shërbesa Pentekostale në Një Shoqëri Relativiste <i>Michael J. Beals</i>	9
Kryqëzim Kulturash: T'ia Komunikojmë Qartë Krishtin një Bote Laike <i>Randy Hurst</i>	15
Arritja e një Gjenerate Postmoderne <i>Josh McDowell</i>	18
Predikimi Biblik për Një Brez të Ri <i>Michael VanDoren</i>	22
Hapat drejt Faljes <i>George O. Wood</i>	26
Impact Kosova 2018 <i>Kurt D. Plagenhoef</i>	32



Tema: Shpallja e së vërtetës në një botë laiike



Shpallja e së Vërtetës në një Botë Laike

Jemi thirrur për të jetuar një jetë e cila është e pëlqyeshme përpara Perëndisë. Gjithçka që bëjmë, gjithçka që themi, vendet ku shkojmë, madje edhe mendimet që mendojmë, duhet t'i japin lavdi e nder Zotit: *"Dhe çdo gjë që të bëni, me fjalë a me vepër, t'i bëni në emër të Zotit Jezus, duke e falënderuar nëpërmjet tij Perëndinë Atë"* (Kolosianëve 3:17). Bibla përmban gjithçka që na nevojitet, për të pasur një jetë të krishterë të suksesshme. Brezit tonë nuk i mungon asgjë, e megjithatë, të paktë janë ata, që e pranojnë se kanë nevojë për Perëndinë në jetën e tyre.

Si kurrë ndonjëherë më parë, nuk është më tepër urgjente dhe më tepër e nevojshme shpallja e së vërtetës që vjen nga Perëndia. Profeti Daniel profetizoi: *"...shumë njerëz do të shkojnë andej-këndej dhe dituria do të shtohet"* (Danieli 12:4 b). Çdo ditë dëgjojmë për një shpikje të re, e cila, qindra vjet më parë, do t'i kishte lënë njerëzit gojëhapur. Tani ne kemi telefona celularë, kompjuterë dhe pajisje të tjera, që kanë si synim për të na e bërë jetën më të rehatshme. Por, shtimi i diturisë ka sjellë degjenerim në çdo nivel të jetës: *"Dhe, duke qenë se paudhësia do të shumohet, shumëkujt do t'i ftohet dashuria"* (Mateu 24:12). Shumë të krishterë, në vend që t'i qëndrojnë besnikë Fjalës së Perëndisë, e kanë zbutur apo kompromentuar mesazhin

e shpëtimit. Një pastor e pyeti Xhon Ueslin se ç'duhej të bënte për ta shpallur pa frikë gjithmonë gjithë të vërtetën, dhe ai iu përgjigj: *"Lëre Perëndinë të ta ndezë zemrën, dhe pastaj njerëzit do të grumbullohen vetë për të të parë ty se si digjesh për Të"*.

Jetojmë në këtë botë laike, e cila e konsideron Biblën si një mit, të cilit i ka shkuar moda. E vërteta mund të jetë e lashtë, por asaj nuk i ka kaluar koha. Fjala e Perëndisë është po aq e përjetshme, sa ç'është vetë i Lashti i ditëve. *"Gjithnjë, o Zot, fjala jote është e qëndrueshme në qiejt"* (Psalmi 119:89). Të krishterët që besojnë tek Bibla kanë urtësi, ndërsa bota që i rrethon ata, është e zhytur në mëkat e në degjenerim. Jezusi tha: *"Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk do të kalojnë"* (Mateu 24:35). Bota, me gjithë teoritë e filozofitë e saj, do të shkatërrohet kur të vijë Krishti. E vërteta dhe ata që e ndjekin Jezusin, do të rrojnë në përjetësi, sepse Krishti është Udhë, e Vërteta dhe Jeta.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 15
Vjeshtë 2018

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: (+355) 69-406-8956
Email: KTU@icc-al.org




Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Bashkësi të Vogla
me një
PAJISJE MBINATYRORE
për një
Mision të Madh

Nga: FATJON KADIU



Ka diçka tek ne, njerëzit, e cila na shtyn të vlerësojmë dhe t'i japim rëndësi, dukshmërisë ose anës së jashtme të çdo gjëje. Jemi mësuar që shumë gjëra t'i matim duke i etiketuar me "e madhe" ose "e vogël". Për ne si njerëz, ajo që duket, ka shumë rëndësi; pra përmasa e jashtme, përshtypja që na lë forma, e kështu me radhë. Kjo "masë" që përdorim, vlen edhe për sa i përket realitetit frymëror. Duket se kemi tendencën që t'i vlerësojmë edhe realitetet frymërore, bazuar në perceptimin tonë të gjërave të jashtme të cilat i shohim, i prekim, i dëgjojmë, etj. Por Zoti ka një metër tjetër, se si i mat e i vlerëson gjërat.

Tek Libri i Parë i Samuelit, 16:7, lexojmë: "Por Zoti i tha Samuelit: 'Mos ia shiko as pamjen as shtatgjatësinë, sepse unë e kam refuzuar, sepse Zoti nuk shikon si shikon njeriu, njeriu shikon pamjen, kurse Zoti shikon zemrën' ". Kjo histori, në këtë kapitull, është e njohur për ne të gjithë. Zoti dërgon Samuelin, profetin e Tij tek shtëpia e Isait, të vajoste mbretin e ardhshëm të Izraelit, pas dështimit të mbretit Saul për t'iu bindur Zotit. Ndërsa djemtë parakaluan para Samuelit, ky ishte duke kërkuar për një burrë që "t'ia mbushte syrin", siç ishte Eliabi. Por aty, Zoti ndërhyri duke i mësuar profetit një mësim të madh për të gjithë ne: njeriu shikon të jashtmen, Zoti shikon të brendshmen.

Shpesh, kur kërkojmë për besimtarë potencialë për t'i shërbyer Zotit, vëmë në lëvizje parametrat tanë njerëzorë për vlerësimin e tyre. Shohim për aftësitë, zgjuarsinë, karizmën, oratorinë e tyre, etj. dhe duke u bazuar në këto, nxjerrim konkluzione, nëse ai person është apo nuk është i vlefshëm për shërbesën e Zotit.

Por në fakt, Zoti nuk shikon dhe nuk vlerëson kështu. Bibla thotë që çdo besimtar është i vlefshëm për shërbesë. Pali na thotë tek Letra e Parë Drejtuar Korintasve 1:26 - 29:

"Shikoni në fakt thirrjen tuaj, vëllezër, sepse ndër ju ka jo shumë të ditur sipas mishit, jo shumë të fuqishëm, jo shumë fisnikë, por Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobëta të botës për të turpëruar të fortët; dhe

Perëndia ka zgjedhur gjërat jo fisnike të botës dhe gjërat e përçmuara, edhe gjërat që nuk janë, për të asgjësuar ato që janë, që asnjë mish të mos mburret përpara Tij".

Kisha në Korint ishte një kishë me një anëtarësi ku pak ishin të ditur, të pushtetshëm apo në pozita të larta dhe pak ishin me prejardhje fisnike. Pjesa dërrmuese ishin nga ajo që ne e quajmë shtresa e ulët e shoqërisë. Rrjedhimisht, kisha kishte shumëllojshmëri problemesh të natyrave të ndryshme.

Megjithatë, Pali ishte i bindur se ishte Perëndia Ai që ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobëta të botës për të turpëruar të fortët; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat jo fisnike të botës dhe gjërat e përçmuara, edhe gjërat që nuk janë, për të asgjësuar ato që janë, që asnjë mish të mos mburret përpara Tij.

Ndërsa shohim kishat tona në Shqipëri, çfarë shohim dhe si i vlerësojmë ato? Sa mund ta kryejnë ato planin e Zotit? Sa mund të influencojnë ato qytetet apo fshatrat tona? Tendencia jonë është që në radhë të parë të

**Forca e një kishe nuk qëndron
në radhë të parë tek sasia, numrat
që ajo ka, por tek cilësia, zemrat
e përkushtuara që ajo ka
brenda saj.**





shohim numrin e anëtarëve të një kishe të caktuar. Pyetja më e zakonshme është: “Sa anëtarë keni?”. Mendoj se kjo pyetje lidhet me mentalitetin e Samuelit, të cilin Zoti e korrigjoi dhe i mësoi që duhet të shohë ashtu si shikon Zoti, jo anën e jashtme, por të brendshmen.

Si është, pra, realiteti i kishave tona? Shumica e kishave tona mund të konsiderohen si të “vogla”, për shkak se anëtarësia e tyre nuk shkon më shumë se 40 - 50 anëtarë. Nuk janë shumë bashkësitë “mesatare”, me anëtarësi mbi 100 anëtarë. Dhe janë shumë të pakta bashkësitë “mbi-mesataren”, me më shumë se 200 anëtarë. Porë nga sytë dhe mentaliteti njerëzor, si edhe nga realiteti njerëzor, nuk është e vështirë që të dekurajohemi.

Por cila është qasja e duhur dhe pyetja e duhur në lidhje me bashkësitë tona? *Forca e një kishe nuk qëndron në radhë të parë tek sasia/numrat që ajo ka, por tek cilësia/zemrat e përkushtuara që ajo ka brenda saj.* Në fakt, në vend që të pyesim: “Sa anëtarë ka kisha?”, pyetja e duhur do të ishte: Sa *influcë* dhe *fuqi frymërore* ka dhe po ushtron kisha në territorin ku Zoti e ka vendosur.

Bibla thotë se mbreti nuk shpëtohet nga një ushtri e madhe dhe as trimi nuk shpëton për shkak të forcës së tij të madhe (Psalmi 33:16). Është Zoti që jep fitoren; është Zoti që siguron suksesin. Kisha (e madhe apo e vogël) i përket Zotit Jezus. Ai tha: “Unë do të ndërtoj kishën time” (Mateu 16:18). Për shkak se kisha i përket Jezusit, asaj i është deleguar një autoritet frymëror për ta ushtruar në territorin ku është mbjellë. Jezusi tha se kudo ku dy apo tre janë bashkuar në emrin e Tij, Ai është mes tyre (Mateu 18:19). Aty ku Ai është, aty është Fryma e Tij, që me fuqi dëshmon për Krishtin.

Unë besoj se ne kemi nevojë për një zbulës nga Fryma e Shenjtë për të kuptuar potencialin e madh që kemi si kisha për ta çuar përpara Mbretërinë e Perëndisë, me autoritetin që na është dhënë nga Ati në Krishtin. Apostulli Pal tha: “që Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdisë, t’ju japë juve Frymën e diturisë dhe të zbulësës, në njohurinë e tij, dhe t’u ndriçojë sytë e mendjes suaj, që të dini cila është shpresa e thirrjes së tij dhe cilat janë pasuritë e lavdisë së trashëgimisë së tij në shenjtoret, dhe cila është


madhështia e jashtëzakonshme e fuqisë së tij ndaj nesh, që besojmë sipas veprimit të forcës së fuqisë së tij, të cilën e vuri në veprim në Krishtin, duke e ringjallur prej së vdekurish dhe duke e vënë të ulej në të djathtën e tij në vendet qiellore,

përmbi çdo principatë, pushtet, fuqi, zotërim dhe çdo emër që përmendet jo vetëm në këtë epokë, por edhe në atë të ardhme, dhe vuri çdo gjë nën këmbët e tij, edhe ia dha për krye përmbi çdo gjë kishës, e cila është trupi i tij...” (Efesianëve 1:17-19).

Madhështia e jashtëzakonshme e fuqisë së Zotit u vu në lëvizje në Krishtin, kur e ringjalli prej së vdekurish, dhe Krishti tani është në vendet qiellore, duke mbretëruar përmbi çdo fuqi e pushtet të Satanit. Perëndia vuri çdo gjë nën këmbët e Krishtit dhe e ka bërë Atë, kreun e kishës së Tij. Kisha ka autoritetin e Krishtit. Prandaj Zoti mund të bëjë shumë edhe përmes kishave “të vogla”.

Në fillimet e kishës tonë në Fier, kur ishim ende në hapat e parë dhe të paktë në numër, ne vendosëm të besojmë atë që thotë Fjala e Zotit dhe ecëm në ato të vërteta. Ishim duke u lutur fort për drejtim, vajosje e fuqi nga Fryma e Shenjtë, dhe ndjemë se Ai po na thoshte: “Dilni kaq sa jeni dhe predikoni ungjillin kudo përreth jush dhe mbillni kisha të reja”. Në qoftë se do ecnim bazuar në kushtet dhe në situatën tonë, e mira do ishte të prisnim sa të rriteshim në numër dhe pastaj të shërbenim në komunitet. Por ne vendosëm të dalim dhe kemi parë rezultate të mrekullueshme gjatë viteve, ndërsa i kemi shërbyer komunitetit, kemi predikuar ungjillin, jemi lutur për të sëmurët, kemi ndihmuar të varfrit e jemi kujdesur për nevojtarët. Ungjilli është përhapur në Fier dhe fshatra përreth, njerëz janë shpëtuar, janë shëruar, janë çliruar dhe bekuar.

**Zoti nuk ka nevojë për numra
dhe sasi të mëdha që të na japë
fitoren! Fitorja vjen vetëm
nga Zoti.**



Kisha e Zotit është një dritë në qytetin apo fshatin ku ndodhet. Drita ka fuqi ta depërtojë errësirën. Ne si kishë mund të bëjmë shumë, sepse Zoti na ka dhënë autoritet frymëror për të ushtruar influencë, edhe në zonat më të vështira. Zoti i tha Gedeonit: “Shko me këtë fuqi që ke dhe shpëtoje Izraelin...” (Gjyq. 6:14). Ai i thotë kishës së Tij sot, shkoni me këtë fuqi që keni, me kaq burime sa keni, predikoni ungjillin, shëroni të sëmurët, u shërbeni nevojtarëve, etj.

Përpara betejës, Gedeoni grumbulloi 32,000 burra izraelitë për të luftuar midianitët. Ishte një numër i madh, por Zoti i tha që ishin shumë aq dhe lavdia do t'i shkonte Izraelit e jo Zotit për fitoren. Kështu pas disa seleksionimeve, Zoti bëri që 31,700 burra të ktheheshin në shtëpitë e tyre.

Me Gedeonin ngelën vetëm 300 burra, të cilët Zoti i përzgjedhi. Për ne (si për Gedeonin), do të ishte shumë normale që thjesht me ushtrinë prej 32,000 luftëtarësh të marshonim për në luftë, të bindur për fitore. Por Zoti tha: “Jo!”. Zoti nuk ka nevojë për numra e sasi të madhe që të na japë fitoren. Fitorja vjen vetëm nga Zoti.

Moisiu kishte fare pak besim në lidhje me thirrjen që Zoti i dha (Eksodi 3). Ai ishte pothuajse i bindur se Zoti kishte gabuar me zgjedhjen që kishte bërë.

Ai e shihte veten tërësisht të papërshtatshëm e të paaftë për të përmbushur thirrjen e Zotit. Por Zoti i tha: “Çfarë ke në dorë? Atë përdore! Me kaq sa ke, të mjafton ta përmbushësh atë që të kam thirrur të bësh!”.

Unë besoj se kjo është saktësisht ajo që Fryma i thotë kishave tona sot: “Çfarë keni në dorë? Çfarë burimesh keni?”. Dhe përgjigja jonë është: “Zot, ne kemi pak burime njerëzore, kemi pak burime financiare e materiale për ta përmbushur thirrjen Tënde. Ai thotë: “Pak mjafton për mua! Filloni të përdorni atë pak dhe unë do ta shumoj!”.



Le të vëmë në punë kaq sa kemi tani, dhe Zoti do ta shumojë dhe do ta bëjë të frytshme. Sansoni nuk kishte armë të teknologjisë së fundit kundër filistenjve, kur ata i bënë pritë në Lehi. Ai gjeti një kockë të thatë, një nofull gomari dhe me atë në dorë vrau një mijë filistenj. Si ka mundësi? Sekretin nuk ishte as te “arma” që përdori, as tek mjeshtëria e tij, por libri i Gjyqtarëve 15:14 na tregon sekretin e fitores. Aty na thuhet: “...Fryma e Zotit erdhi fuqishëm mbi të...”.

Kjo është ajo për të cilën më së shumti kemi nevojë, që Fryma e Zotit të vizitojë kishat tona me fuqinë e Tij, që Fryma e Zotit të vijë përmbi pastorët, bashkëpunëtorët dhe gjithë besimtarët për të na fuqizuar që të shpallim me guxim ungjillin kudo ku jemi. Sot më shumë se kurrë, ne kemi nevojë për fuqizim nga Fryma e Shenjtë mbi kishat tona që të mund të bëjmë veprat e Jezusit, aty ku Ai na ka caktuar.

Kisha është krijuar nga Zoti për të ushtruar influencë frymërore dhe për të mposhtur forcat demonike të mosbesimit, të materializmit, fetarizmit, indiferentizmit që mbizotërojnë mbi vendin tonë. Zoti ka vendosur në ADN-në e kishës së Tij, fuqinë dhe aftësinë për të



dominuar, për të luftuar dhe mposhtur mbretërinë e errësirës dhe për të stabilizuar mbretërinë e Perëndisë në çdo territor ku Kisha gjendet. Unë besoj fort se kisha e Jezusit ka një mandat nga Zoti, jo për të mbijetuar, por një mandat për të mposhtur e për të fituar mbi pushtetin e errësirës dhe që të përhapë mbretërinë e Perëndisë mbi tokë.

Kisha, në ADN-në e saj, ka rritjen dhe shumëfishimin, edhe në rrethanat më armiqësore. Ne mund të shohim burimet tona dhe të dekurajohemi, por Zoti na ka dhënë burime frymërore të pashtershme.

Kur Izraeli po bëhej gati të hynte në tokën e premtuar, Zoti i bëri popullit këtë premtim: "Unë ju kam dhënë çdo vend ku tabani i këmbës tuaj ka për të shkelur". Çfarë premtimi madhështor! Ky është një premtim edhe për kishën sot. **Në çdo territor të Shqipërisë dhe të Ballkanit ku kishat tona gjenden sot, Zoti na thotë: "Jua kam dhënë juve!"**

Gjithmonë marr inkurajim nga historia e apostullit Pal, kur ai ishte në Korint, siç përshkruhet tek Veprat 18. Pali ishte duke predikuar ungjillin e

Jezusit, por dukej se nuk kishte fare depërtim dhe se në atë qytet të madh ku mbizotëronte idhujtaria, imoraliteti, lakmitë e çdo lloj ligësie e papastërtie tjetër, nuk po përparonte ungjilli. Vetë Fryma ishte duke e shtyrë apostullin që të dëshmonte për Krishtin. Ai provoi shumë mënyra, por po haste vetëm kundërshtime dhe rezistencë. Ishte në kufijtë e dekurajimit, por Zoti i foli e i tha: "Mos druaj, por fol dhe mos pusho, sepse unë jam me ty dhe askush nuk do të vërë dorë mbi ty që të të bëjë keq, **sepse unë kam një popull të madh në këtë qytet**". Veprat 18:9 - 10.

Ai qëndroi aty një vit e gjysmë, predikoi e mësoi Fjalën e Perëndisë dhe aty u themelua një kishë e fortë.

Le të marrim zemër! Ndoshta në vendin ku jemi, kemi vite që po mbjellim, po predikojmë, po shërbejmë dhe duket sikur nuk ka fare depërtim. Por le të inkurajohemi, sepse koha e korries po vjen! Zoti ka një popull të Tij në vendin ku jemi.

Kishat tona - bashkësitë e besimtarëve - kudo ku janë në Shqipëri, janë vepra e Zotit. Ai na ka mbjellë, na ka pajisur me autoritet frymëror, na ka vënë në dispozicion fuqinë e Frymës së Tij dhe premtimet e çmuara në Fjalën e Tij, që të mund të dalim si fitimtarë, duke shpallur me besim e guxim ungjillin, që është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e kujtdo që beson.

Le të këmbëngulim e të mos lodhemi së luturi për rizgjim mbi qytetin e kombin tonë! Le të vazhdojmë të lutemi për më shumë fuqi nga lart, nga Fryma e Shenjtë mbi kishat tona! Le të mos lodhemi duke mbjellë, sepse koha e korries po vjen! Le të mësojmë që të ecim si fitimtarë me autoritetin që Krishti na ka dhënë dhe të fitojmë të humburit për Të!



FATJON KADIU, pastor,
Kisha Lajmi i Mirë, Fier

SHËRBESA PENTEKOSTALE

në një



Shoqëri Relativiste

Nga: MICHAEL J. BEALS

VERTETË

Brisku i Okhamit - Henoteizmi - Iluminizmi - Dyshimi: Marks, Niçe dhe Frojdi - Solipsizmi - Postmodernizmi - Relativizmi - Njeriu është njësia matëse - Supersticioni: Aeropagu - Supersticioni Politeist - Laicizmi - Brisku i Okhamit - Henoteizmi - Iluminizmi - Dyshimi: Marks, Niçe dhe Frojdi - Solipsizmi - Postmodernizmi - Relativizmi - Njeriu është njësia matëse - Supersticioni: Aeropagu - Supersticioni Politeist - Laicizmi - Brisku i Okhamit - Henoteizmi - Iluminizmi - Dyshimi: Marks, Niçe dhe Frojdi - Solipsizmi - Postmodernizmi - Relativizmi - Njeriu është njësia matëse - Supersticioni: Aeropagu - Supersticioni Politeist -

Unë ia dorëzoja jetën Krishtit në një kohë kur shtegtimi krijues drejt muzikës bashkëkohore të krishterë sapo kishte filluar të merrte vull. Për shkak se ky ndryshim ende nuk kishte ndodhur plotësisht, gjatë asaj kohe unë u "ngopa" me fuqinë dhe pasurinë e himneve madhështore të kishës gjatë viteve të mia të para si besimtar. Por, mos më keqkuptoni, mua më pëlqen larmia, energjia dhe krijimtaria e adhurimit bashkëkohor. Gjithsesi, në ato vite, mora një dhunti që do të doja të ishte më gjerësisht e përhapur te besimtarët e sotëm.

Përtej ndjesisë së qartë të pranisë së Perëndisë dhe reagimeve tona ekspresive ndaj lëvizjes së tij në mesin tonë, këto himne ngulitën tek unë doktrinën e besimit. Së bashku me predikimin biblik, himnet kanë funksionuar duke më ndihmuar që të ndërtoj një themel të patundur të besimit tim. Në veçanti, ato më kanë mësuar një fakt të thjeshtë: *se e vërteta nuk është sipas mendjes sime.*

Kur e vërteta kthehet në një gjë që është *sipas mendjes sime*, unë bëhem një relativist. Në qoftë se mbliidhem me njerëz të tjerë që kanë mendime të ngjashme, dhe horizonti i së vërtetës janë bindjet tona të përbashkëta, atëherë të gjithë ne jemi relativistë. Sa prej nesh kemi pasur një përvojë kur dikush ka reaguar ndaj pohimeve tona në lidhje me të vërtetën e Shkrimit me një shprehje të tillë: "Epo, kjo është e vërtetë për ty"? Ja, ky është *relativizmi*, pra, besimi se e vërteta funksionon në një mënyrë lokale. Për disa njerëz, standardi se çfarë është e drejtë apo e gabuar, e vërtetë apo e rreme, vepron vetëm brenda përbrenda mendjes së një personi ose brenda marrëveshjeve të një grupi. Për ta, nuk ekziston ndonjë sistem objektiv dhe i mbinatyreshëm i të

vërtetës apo i parimeve morale, mbi të cilat të bazojnë pretendimet dhe për të cilat, në fund të fundit, gjithkush është përgjegjës.

Relativizmi është një formë e veçantë mosbesimi që është goxha i përhapur në kulturën tonë. Ai paraqet disa sfida të frikshme në lidhje me prezantin e ungjillit si zbulesën unike të Perëndisë tek njerëzimi dhe si shpresën e vetme për jetë të përjetshme. Relativizmi i detyron njerëzit të jenë dyshues, në mos tërësisht kundërshtues, ndaj një mesazhi të tillë përjashtues. Por në këtë mes ka më tepër sesa thjesht një mesazh.

Fuqia e Frymës së Shenjtë shkon përtej kufizimeve tona për të komunikuar një të vërtetë që zgjat, dhe depërton përmes sistemeve të rreme të mendimit me anë të ndriçimit të mendjes dhe bindjes së plotë. Unë besoj se Perëndia na ka ngritur në pentekostalët "për një kohë të tillë" (Esteri 4:14).

Për nga vetë përkufizimi, relativizmi nuk mund të kundërshtohet me anë të një përqasjeje karshi dëshmisë së krishterë, e cila është e rrënjësuar në triumfalizmin racional e intelektual. E vërteta nuk është vetëm objektive; por është e mishëruar në personin dhe në veprën e Zotit tonë Jezu Krisht. Detyra jonë parësore është që të fitojmë njerëz për Krishtin, jo të fitojmë debate.

Richard Mouw, në librin e tij me titull "E vërteta e shtrembëruar: Çfarë duhet të dijë çdo i krishterë në lidhje me betejën për mendjen" (*Distorted Truth: What Every Christian Needs to Know About the Battle for the Mind*), i paralajmëron të krishterët që t'i shmangen tundimit për të kërkuar "fitore retorike të pavlera ndaj mosbesimit". Me këtë ai i referohet tendencës që të krishterët kanë për të nxjerrë në pah kontradiktat e sistemeve të besimit të jo të krishterëve, për të shfaqur qëndrueshmërinë

THEA

dhe Frojdi - Solipsizmi: Postmodernizmi - Relativizmi - Njeriu është njësi matëse - Supersticioni: Aeropagu - Supersticioni Politeist - Laicizmi - Brisku i Okhamit - Henoteizmi - Iluminizmi - Dyshimi: Marks, Niçe dhe Frojdi - Solipsizmi: Postmodernizmi - Relativizmi - Njeriu është njësi matëse - Supersticioni: Aeropagu - Supersticioni Politeist - Laicizmi - Brisku i Okhamit - Henoteizmi - Iluminizmi - Dyshimi

superiore të krishterimit. Për shembull, sa prej nesh i kanë ngritur këtë kurth një relativisti që nuk dyshon për keq:

Relativisti: "Ajo që më shqetëson mua në lidhje me Krishterimin është fakti se është shumë paragjykes. Unë nuk besoj se ekziston një e vërtetë e vetme apo një grup rregullash të cilat zbatohen për këdo dhe në çdo vend. E vërteta dhe parimet morale janë relative për kulturën apo për grupin në të cilin kanë ndikim".

- I krishteri: "Pra, ju po thoni që nuk ekzistojnë vlera absolute?"
- Relativisti: "Po, pikërisht këtë po them".
- I krishteri: "Asnjë, asnjë?"
- Relativisti: "As edhe një."
- I krishteri: "Ja, kjo që sapo thatë është një vlerë absolute".

Kjo lloj qasjeje mund të fitojë pikë gjatë një debati, por nuk bën asgjë për të fituar zemrën e një personi. Për të arritur këtë qëllim, Mou beson se është e rëndësishme të këqyrim nën sipërfaqen e gabimit për të hetuar burimet dhe pasojat e këtyre sistemeve të rreme të mendimit.

Kishat sot funksionojnë në kontekstin relativist të një kulture më të gjerë, e cila në rastin më të mirë të saj është dyshuese ndaj pretendimeve me autoritet rreth të vërtetës dhe parimeve morale, ndërsa në rastin më të keq i konsideron këto pretendime si burimet parësore të të ligut dhe të tiranisë në botë.

Si arritëm në këtë pikë?

A është relativizmi një fenomen bashkëkohor? Apo ndoshta është një manifestim i përhershëm i gjendjes së rënë njerëzore, i cili e rikrijon veten e vet në çdo brez? Unë besoj se është kjo e fundit. Për të kuptuar dhe për t'u përballur me sfidat që

relativizmi paraqet për të krishterët e këtij brezi, është me vlerë që ta gjurmojmë relativizmin në pasqyrimet e tij të ndryshme përgjatë historisë.

Njeriu është njësi matëse

Sokrati, një filozof grek, ishte i bindur se personat që ishin të përkushtuar ndaj arsyes do të zbulonin standardet e të vërtetës objektive, e cila ishte e huaj për ta, dhe, duke i vënë në jetë këto të vërteta, do të ishte e mundur të arrihej jeta e dëshiruar. Sofistët, kundërshtarët e tij, e mohanin superioritetin e një standardi të vetëm dhe objektiv të së vërtetës apo të mirësisë. Protagora, një filozof sofist, ka deklaruar shprehjen: "*homo mensura*" (njeriu është njësi matëse); e vërteta është relative për personin që bën pohimin. Kjo trashëgimi e sofistëve është gdhendur në gjithë tablonë e historisë dhe nuk e ka humbur fare fuqinë e saj. Sot, njerëz nga të gjitha sferat e jetës e shtrembërojnë ose e braktisin të vërtetën në interes të preferencave, kënaqësisë apo përfitimit.

Areopagu

Një tjetër formë e fuqishme e relativizmit është besëtytnia politeiste. Pali e has këtë koncept në Athinë (Vep. 17:16 - 34). Duke parë një qytet plot me idhuj, Pali "po i ziente fryma përbrenda". Ndërkohë që po ngjitej për në Areopag, ai vështroi perënditë e shumta dhe të ndryshme që njerëzit adhuronin, dhe e përdori këtë larmi si një trampolinë për të ungjillëzuar. Në mesin e alternativave që ishin në dispozicion, Pali shpalli se ekzistonte vetëm një alternativë e vërtetë.

Besimi se njerëzit përzgjedhin kë apo çfarë do të adhurojnë, ndërkohë që pranojnë vlefshmërinë e alternativave të tjera, quhet *henoteizëm*. Heno-

teizmi është shëndoshë e mirë sot, në interesin e përtërirë të natyrës frymërore, e cila është pjesë e postmodernizmit të kohëve tona. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të bëjmë një dallim të qartë midis respektit që kemi për njerëzit e tjerë dhe pranimit si të vërtetë të sistemit të tyre të besimit. Një perëndi të cilin secili prej nesh mund ta zgjedhë sipas mendjes së vet, nuk mund të na çlirojë nga mëkati dhe ai as nuk mund t'i përmbushë dëshirat e mëdha të zemrës sonë.

Laicizmi

Ndërkohë që civilizimi në perëndim po dilte nga periudha e mesjetës, Iluminizmi, një lëvizje gjithnjë e në rritje, i identifikoi të gjitha format e fesë si besëtytni dhe si të panevojshme. Kjo periudhë shtroi rrugën për laicizmin e epokës së modernizmit.

Përgjatë shekullit të 16-të e më pas në shekullin e 17-të, një numër gjithmonë e më i madh i studiuesve të Iluminizmit po kërkonin që ta shkëpusnin progresin intelektual nga autoriteti i Kishës dhe i Shkrimit. Rezultati i kësaj ishte një ndarje midis shkencës (fushës së fakteve objektive) dhe fesë (sferës së vlerave subjektive). Vetëm ato deklarata që mendohej se ishin të vlefshme nga ana racionale apo të verifikueshme nga ana empirike konsideroheshin faktike, dhe, si rrjedhojë, të vërteta. Kjo ndarje mes fakteve dhe vlerave pati rrjedhoja të cilat u shtrinë në shumë fusha. Për shembull, në sferën e drejtësisë civile, dikush mund ta përkufizonte vjedhjen në mënyrë faktike si një konfiskim pa leje të pronës së tjetrit. Si e tillë, kjo ishte një sjellje e papranueshme për shkak se ishte kundër të mirës së përbashkët. Por, sipas këtij mentaliteti të ri, vjedhja nuk mund të konsiderohej më si e gabuar duke u bazuar mbi ndonjë standard të vlerave të mbinatyrshe për shkak se shumë vetë refuzonin që ta shihnin fenë si kriterin bazë për parimet morale.

Marks, Niçe dhe Frojdi

Aty nga shekulli i 19-të dhe fillimi i shekullit të 20-të, shpresa e progresit të pashmangshëm që njerëzit besonin se mund të arrihej përmes shkencës dhe teknologjisë i hapi rrugën izolimit dhe dëshpërimin. Forcat laike të modernizimit kishin kohë që përpiqeshin të arrinin dy gjëra njëkohësisht; pra, të miratonin ekzistencën e njohurisë objektive, ndërkohë që mohonin Burimin e mbinatyrshtëm të së vërtetës. Mes të tjerëve, Marks, Niçe dhe Frojdi, u pozicionuan me doktrinën moderne e cila thoshte se projektimi dhe rregulli në univers ishin të mundur edhe pa ekzistencën e një Projektuesi. Njerëzit ose kombet që kishin pushtetin për ta imponuar vullnetin e tyre, formuan dhe vendosën drejtësinë, bashkë me të vërtetën dhe parimet morale. Relativizmi kishte arritur pjekurinë e tij.

Postmodernizmi

Ndërkohë që shekulli i 20-të vazhdonte, themelet e modernizmit u thërrmuan (Diogenes Allen). Laicizmi kishte dështuar, duke mos arritur dot që të jepte shpjegime të mjaftueshme për shumë gjëra, që nga origjina e ekzistencës e deri tek dëshirat e mëdha të frymës njerëzore. Një pjesë e madhe e strukturave shoqërore dhe intelektuale të modernizmit janë ende të dukshme, por ato janë mbetjet të kalbura të premtimeve që nuk janë mbajtur.

Postmodernizmi vjen me formën e vet të relativizmit, pra, të besimit se vetja (individi) është "gjëja më reale [që ekziston]" (James Sire). Sigurisht që e vërteta, parimet morale dhe vetë bota janë diku atje, por ajo që ka më shumë rëndësi është mënyra se si e përqafoj unë të vërtetën, rregullat dhe botën, dhe si i bëj ato pjesë të vetes sime.

Në postmodernizëm, njerëzit grumbullohen në grupe që kanë qëllime, besime ose sjellje të përbashkëta, por gjithashtu, lëvizin brenda dhe jashtë komuniteteve të ndryshme dhe e përshtatin gjuhën dhe stilin e tyre të jetesës sipas mënyrës së duhur kontekstuale. Kjo nuk është një gjë e re në vetvete, por jep një leje që nuk ka precedent, për të refuzuar pasjen e një qenieje individuale thelbësore dhe për të adoptuar një *identitet në bazë të situatës*. Si rrjedhojë, kisha mund të vazhdojë të mbetet një komunitet domethënës me të cilin unë mund të bashkohem, por ajo nuk është në asnjë mënyrë diçka ekskluzive (madje as parësore), kur vjen puna tek ndikimi apo pretendimet e saj.

Ky skicim i trashëgimisë së relativizmit nxjerr në pah kontekstin në të cilin shërbejmë dhe udhëheqim. Sfidat janë goxha të mëdha, por cilësitë dalluese të shërbesës pentekostale janë të përshtatshme në mënyrë unike dhe hyjnore për të depërtuar përmes rezistencës së atyre që kundërshtojnë mundësinë e diçkaje absolute: qoftë të vërtetën apo Atë që është e vërteta.

PËR NJË KOHË TË TILLË

Një nga sfidat kryesore të shërbesës, në një kulturë relativiste, është në fushën e autoritetit biblik. Shtimi i informacionit në internet shërben për të ushqyer më tej skepticizmin karshi cilitdo zëri që pretendon se është autoriteti përfundimtar. Sulmet e vazhdueshme ndaj çdo tregimi që pretendon autoritetin përfundimtar, mund të lërë gjurmë, madje edhe në mendjet e atyre që janë besnikë, të cilat ndikojnë në reagimet e tyre ndaj udhëheqjes së kishës. Çështja këtu është autoriteti i fjalës së Perëndisë për të përshkruar realitetin, për të përkufizuar të vërtetën dhe për të drejtuar sjelljen. Ne duhet të praktikojmë përgjithësisht kur vëmë në zbatim shembujt tanë shpjegues, mirëpo fjalët tona duhet të përfaqësojnë Fjalën, qoftë kur jemi duke predikuar, këshilluar apo korrigjuar (ndrequr). I njëjti Frymë i gjallë i Perëndisë, që frymëzoi autorët njerëzorë të Shkrimit, shpall fjalë pohuese në zemrat e çdonjërit që dëgjon fjalët e tij me një zemër të hapur për të pranuar.



E kam parë shumë herë Perëndinë të punojë në këtë mënyrë. Për shembull, një çift i ri, i ulur në zyrën time, po më shikonte me habi. Ata e kishin pranuar Krishtin në një fushatë ungjillëzimi në një stadium kohët e fundit dhe kishin filluar të vinin në kishën tonë. Kur më kërkuan të kryeja ceremoninë e tyre të martesës, unë pranova me kënaqësi dhe iu sugjeroja nevojën për këshillim paramartesor. Gjatë seancës së parë, nusja e ardhshme më pyeti: "Pastor, vërtet po na sugjeron që njëri prej nesh duhet të dalë nga apartamenti ynë deri pas ditës së dasmës? Ne kemi dy vjet që jetojmë bashkë".

I sigurova që po sugjeroja vërtet atë gjë duke i çuar tek Fjala e Perëndisë. Punuam së bashku duke parë disa fragmente nga Bibla që zbuluan dashurinë e mrekullueshme të Perëndisë për ta, si dhe fuqinë dhe bekimin që Ai do të çlironte në jetët e tyre, në rast se ata do t'i nënshtroheshin Atij në këtë pikë të rëndësishme. E dija që vetëm arsyeja nuk do të mjaftonte për t'i bindur. Nuk u përpoqa aspak që t'i detyroja duke përdorur pozicionin tim. Deri në këtë pikë të marrëdhënies së tyre, jeta e tyre ishte e mbushur nga shumë zëra që ndikonin me miratimin e tyre në stilin e jetesës që ata bënë. Unë përdora zërin tim për të shprehur pozicionin e Shkrimit dhe u luta që Fryma t'ua ndriçonte të

IMPLIKIMET E RELATIVIZMIT

Betejat e shoqërisë rreth të vërtetës kanë efekte me ndikim të gjerë. Duke parë përhapjen e relativizmit në shoqërinë tonë, duhet që të marrim shkurtime në konsideratë disa nga implikimet e tij.

Një nga implikimet, të paktën në frontin fetar, është se përpjekja për të bindur dikë është e ndaluar. Në shumë prej universiteteve, ungjillëzimi (që është edhe fjala tabu në fushën e prozelitizmit apo konvertimit) shihet si "t'ia zhyshen fenë tënde në fyt dikujt tjetër". Përpjekja për të bindur apo për të ungjillëzuar dikë, qartësisht nënkupton se ju keni një të vërtetë për të shpallur, dhe nënkupton se ju mendoni që dëgjuesit tuaj e kanë shumë gabim.

Kjo na sjell tek implikimi i dytë: në rast se flet për ekskluzivizëm do të thotë që je arrogant. Duke marrë shkas nga numri i besimeve të ndryshme fetare nëpër botë, atëherë pretendimi se dimë diçka, për të cilën të tjerët janë injorantë, duhet patjetër që të jetë i gabuar dhe kokëfortë. Për më tepër, pretendimet ekskluzive, veçanërisht në lidhje me veçorinë unike të Krishtit për të na shpëtuar, shpeshherë ngatërrohen me kolonializmin dhe imperializmin perëndimor, që nuk është asgjë më shumë sesa fanatizëm dhe mendjengushtësi, pra, një lloji imponimi perëndimor i ideve tek ata dëgjues të cilët nuk janë të përgatitur apo të vetëdijshëm. (Patjetër që, në disa raste, jo të krishterët kanë arsye të përligjura për të qenë kritikues ndaj nesh. Të krishterët i japin shkas armiqësive kur thonë me zë të lartë se Krishterimi është i vërtetë dhe ekskluziv, ndërkohë që njëkohësisht bërtasin me të madhe se pikëpamjet e tjera nuk mbartin asnjë lloj të vërtete. Në të vërtetë, të krishterët mund të vlerësojnë shumë nga të vërtetat që gjenden brenda besimeve të tjera. Duke qenë se të gjitha të vërtetat janë të vërtetat e Perëndisë, atëherë të vërtetat morale, për shembull, mund të gjenden edhe jashtë Biblës, njësoj siç mund të jenë të vërtetat nga matematika, historia dhe shkenca¹).

Një tjetër implikim është që toleranca është virtyti themelor. Nënkuptimi se dikush e ka gabim nuk është aspak tolerant, veçanërisht kur, në mënyrë popullore, por të gabuar, toleranca përkufizohet si: të qenit të hapur dhe pranues ndaj të gjitha ideve. Për shembull, ajo që aktivistët homoseksualë quajnë tolerancë, në fakt, është pranimi pa kushte se stili i tyre i jetesës është i ligjshëm dhe i drejtë. Ky qëndrim i të qenit mendjehapur në fakt del se

është të qenit kokëbosh. Këtij qëndrimi i mungon aftësia dalluese dhe çdo lloj kriteri për pranueshmëri. Duke përdorur fjalët e Allan Bloom, "çiltërsia ka qenë virtyti që na lejonte të kërkonim të mirën duke përdorur arsyen. Ndërsa tani do të thotë që të pranojmë gjithçka dhe të mohojmë fuqinë e arsyes".²

Një implikim i fundit i relativizmit, që ndoshta shpjegon më së miri se si argumentet tona rreth të vërtetës fillojnë edhe ndihen sikur jemi në luftë, është: Kur mundësia e të vërtetës mungon, sundon pushteti. Që do të thotë se, kur e vërteta është çfarë duam ne të jetë, atëherë hapi tjetër i natyrshëm është që të kërkojmë pushtetin tonë mbi të tjerët. Filozofi gjerman, Friedrich Nietzsche, 1844 - 1900, ka shkruar se shuarja e Perëndisë (dhe rrjedhimisht e të gjitha standardeve objektive të së vërtetës dhe parimeve morale), do të na çonte në një epokë nihilizmi, duke pasur si pasojë refuzimin e të gjithë kuptimit dhe vlerës objektive.³ E gjitha ajo që mbetet është vullneti i fuqisë, me anë të të cilit mbijeton vetëm më i forti.

Stanley Fish nga universiteti "Duke", i cili është i mirënjohur për mospranimin e tij të standardeve objektive letrare apo morale, ka thënë: "Gjithmonë do të jetë dikush në radhë i cili do të kufizohet, dhe detyra juaj është të siguroheni që ai dikush të mos jeni ju"? Shumë grupe të interesave të veçanta sot, edhe pse sigurisht jo të gjithë, operojnë sipas këtij parimi: Për shkak se nuk kanë ndonjë standard objektiv me anë të të cilit funksionojnë, pra asnjë provë se ajo që përkrahin është e mirë apo e drejtë, atëherë e vetmja gjë që mund të bëjnë ata është që ta ushtrojnë pushtetin për të legjitimizuar pikëpamjet e tyre, që zërat e tyre të dëgjohen dhe që të nxisin ndryshimin. Qeveria apo strukturat e tjera sociale kthehen në vegla për pushtet, që përdoren nga elitat e shoqërisë dhe nga grupet e interesit të cilët kanë fituar më shumë ndikim dhe pushtet sesa palët e tjera.

Dhe përsëri, kjo është vëzhguar që prej lash-tësisë. Në një nga dialogët e tjerë të Platonit, të quajtur "Dialog me Gorgias", një burrë me emrin Kaliko shpall se drejtësia, në të vërtetë, është thjesht sundimi i të fuqishmëve mbi qytetarët e një shteti. ? Çfarëdo gjëje që është më e mira për sundimtarin është

natyrshëm e drejtë, sipas Kalikos. Parimet morale janë katandisur në mënyrë arbitrare në çështje pushteti.

Ky është ambienti ku ne flasim, pra, një ambient relativist, i vetëdijshëm për pushtetin, armiqësor ndaj pretendimeve për të vërtetën, veçanërisht ndaj atyre që burojnë nga besimi. Megjithatë relativistët pretendojnë se zotërojnë etiketimin "tolerantë", ndërkohë që i bëjnë kritikë relativizmit objektiv dhe moral, do të shohim se si kjo filozofi e pakuptueshme, e cila bie ndesh me veten e vet, është shumë herë më tepër dogmatike dhe mendjengushtë nga Krishterimi? Çuditërisht, është shumë ironike që, pavarësisht akuzave se të krishterët janë fanatikë dhe zemër-ngushtë, pozicioni i tyre absolutist, jo vetëm që është i vërtetë, por është edhe i qëndrueshëm, edhe i dhembshur.



PAUL COPAN, West Palm Beach, Florida. Ribotuar nga libri: "E vërtetë për ty, por jo për mua" (True for You, But Not for Me) (Minneapolis: Bethany House Publishers, 1998), 21, 22. Përdorur me leje.

Shënime

1. Harold Netland, Zëra të papajtuësishëm (Dissonant Voices) (Virginia Beach, Virginia: Regent College Publishing, 1999), 144. Shih gjithashtu librin e Lesslie Newbigin, Finaliteti i Krishtit (The finality of Christ) (Atlanta: John Knox, 1969), 11, 12; dhe Aldous Huxley, Filozofia e Përditshme (The Perennial Philosophy) (New York: Harper and Row, 1944), 140, 141.
2. Allan Bloom, Mbyllja e mendjes amerikane (The closing of the American Mind) (New York: Simon and Schuster, 1988), 38.
3. "Shkenca e lumtur" ("The Gay Science"), te libri: Nicja portativ (The Portable Nietzsche), red. dhe përk. nga Walter Kaufman (New York: Viking, 1954), 95.
4. Cituar nga libri i Gene Edward Veith, Jr., Kohë Postmoderne (Postmodern Times), (Wheaton, Illinois: Crossway Books, 1944), 163.
5. Për shembull, Dialogu me Gorgias, 49, 1b. Gjithashtu te dialogët e tjerë të Platonit: Teeteti (Theaetetus), te Sofisti (Sophist), dhe te Burri i Shtetit (Statesman).
6. Alistair McGrath, "Sfida e pluralizmit për kishën bashkëkohore" (The Challenge of Pluralism for the Contemporary Church), në Gazetën për Shoqërinë Teologjike Ungjillore (Journal for the Evangelical Theological Society), nr. 35 (Shtator 1992), 363.

vërtetën. Dhe ashtu ndodhi. Në takimin tonë të radhës, ata më thanë se nuk po jetonin më bashkë. Ceremonia e martesës ishte një kremtim i hirit.

Një tjetër sfidë me të cilën përballen pastorët në këtë kulturë relativiste është mënyra e pashoqe me të cilën përshtaten njerëzit me sisteme arsyesimi dhe rregullash që janë kontradiktore, ndërkohë që operojnë në komunitete të shumëfishta. Në kohën kur isha një besimtar i ri, dëgjova një predikim i cili më këshillonte të mos jetoja një jetë të dyfishtë. Në ditët e sotme, këshillimi që vjen nga katedra është që ne të mos jetojmë jetë të shumëfishta.

Jashtë kishës, njerëzit e kanë lirinë që të jetojnë jetë të shumëfishta. Një rezultat i kësaj lirie është fakti se *integriteti* ka marrë kuptimin e të jetuarit sipas rregullave të grupit ku bën pjesë.

Fryma e Perëndisë na fuqizon që të vendosim besnikërinë tonë si prioritet dhe të vëmë vlerat tona në zbatim në çfarëdo konteksti. Ai bëhet ortak me ne për të kultivuar dhe për të shfaqur frytet e Frymës në çdo kohë dhe në çdo vend. Para çdo anëtarësimi tjetër profesional apo personal, ne jemi anëtarë të shtëpisë së besimit (Galatasve 6:10), dhe Fryma e Shenjtë na jep sigurinë e anëtarësimit në familjen e tij (Romakëve 8:16).

Ne sfidohemi edhe më tej ndërkohë që kërkojmë të ngulitim identitetin vetjak në një standard objektiv të individualitetit njerëzor. Duke pasur si udhërrëfyes refuzimin e së vërtetës, njerëzit kalojnë vite e vite duke rrënuar në mesin e gërmadhave të modernizmit, duke provuar botëkuptime që nuk kanë asnjë ngjashmëri me njëri-tjetrin dhe duke u përpjekur të formojnë një identitet me ideale të papajtueshme dhe shpeshherë të paarsyeshme. Kjo gjë është në kontrast të thellë me identitetin e atyre që kanë pranuar Krishtin. Për sa kohë që burrat dhe gratë vazhdojnë të mbeten njësisht matëse e të vërtetës apo e mirësisë, kërkimi për domethënie vetjake dhe për përmbushje do t'i lërë të zbrazur dhe të vetmuar. Por, kur jobesimtarët ndeshen me realitetin e punës pentekostale në jetën e popullit të Perëndisë, atëherë ata hasin një grimcë të bujarisë së hirit të Perëndisë, dhe kanë dëshirë të ndihen pjesë e tij. Kështu ndodhi në jetën time. Kur isha 18 vjeç, nuk kisha asnjë përvojë me krishterimin e vërtetë, dhe tashmë isha lodhur duke rrënuar. Pranova ftesën për të marrë pjesë një pasdite në një takim kishë. Aty pashë njerëz që reagonin me gëzim dhe pa turp ndaj lëvizjes së Frymës së Shenjtë. Kaq shumë u preka nga çiltërsia dhe fuqia e asaj që pashë, sa që e dija se kisha gjetur atë që ma dëshironte zemra. Ia

thashë këto gjëra pastorit të të rinjve, dhe po atë natë, ia dorëzoja jetën time Jezui Krishtit. Më shumë se 30 vjet më vonë, unë e falënderoj vazhdimisht Zotin që më bëri dishepullin e tij, birin e tij dhe trashëgimtarin e tij.

PËRMBYLLJA

Sfidat e relativizmit nuk janë të reja për shërbesën me besnikëri. Tundimi që njerëzit ta vendosin veten e tyre si njësinë matëse të së vërtetës dhe të mirësisë filloi që me Adamin dhe Evën dhe ai e rikrijon vetveten në çdo brez. Relativizmi i bën njerëzit që të mos gjejnë prehje. Kjo mungesë prehjeje është një aleatë vendimtare në luftën kozmike për shpirtat e burrave dhe të grave. Shën Agustini i dha zë pikërisht kësaj dëshire të madhe që i gjithë njerëzimi ka për Krijuesin e tij kur shkroi: "zemra jonë nuk gjen prehje, derisa të pushojë në ty" (*Rrëfimet*).

Kishat aktive, të cilat janë të gjalla në Frymë, sigurojnë një strehë entuziaste dhe të qëndrueshme për ata që dëshirojnë të kenë një themel të patundur dhe të qëndrueshëm. Fuqia e ditës së Rrëshajave është një litar shpëtimi për njerëzit që jetojnë me pasigurinë brejtëse të një identiteti të bazuar te situata. Pastorët duhet t'i inkurajojnë bashkësitë e tyre që t'i jetojnë në praktikë identitetet e tyre pentekostale pa asnjë mëdyshje, dhe me një vendosmëri të përlur për të përmbushur Porosinë e Madhe për shkak se Zoti ka derdhur tek ne Frymën e tij për një kohë të tillë.

Lista e materialeve të përdorura

Allen Diogenes. 1989. Besimi i krishterë në një botë postmoderne: E gjithë pasuria e bindjes (*Christian Belief in a Postmodern world: The Full Wealth of Conviction*). Louisville: Westminster John Knox Press.

St. Augustine. 1961. Rrëfime. Përkthyer dhe me një parathënie nga R. S. Pine-Coffin (*Confessions*. Translated with an introduction by R. S. Pine-Coffin), New York: Penguin Books.

Mouw, Richard J. 1989. E vërteta e shtrembëruar: Çfarë duhet të dijë çdo i krishterë në lidhje me betejën për mendjen (*Distorted Truth: What Every Christian Needs To Know About the Battle for the Mind*). Pasadena: Fuller Seminary Press.

Sire, James W. 2004. T'i vëmë emrin elefantit: Botëkuptimi si një koncept (*Naming the Elephant: Worldview as a Concept*). Downers Grove: Intervarsity Press.

Warren, Rick. 2002. Të jetosh sipas qëllimit: Për çfarë jam më në fund këtu? (*The Purpose Driven Life: What on Earth Am I Here For?*) Grand Rapids: Zondervan.



MICHAEL J. BEALS, Ph.D., pastor kryesor në kishën komunitare Kodrat e Misionit, në qytetin Rancho Santo Margarita të Kalifornisë. Ai shërben si ndihmës pedagog për lëndët e Teologjisë Filozofike dhe të Etikës së Krishterë në Universitetin e Vanguardit, si edhe si pedagog zëvendësues për lëndët e Filozofisë dhe të Etikës në seminarin teologjik Fuller.



KRYQËZIM KULTURASH- T'IA KOMUNIKOJMË QARTË KRISHTIN NJË BOTE LAIKE

Nga: **RANDY HURST**

Jezusi jetoi dhe vdiq në udhëkryqet e njerëzimit. Kur Ai u kryqëzua, Pilati dha urdhër që mbishkrimi në kryq të shkruhej në hebraisht, latinisht dhe greqisht, të cilat ishin gjuhët e tri grupeve kulturore më të mëdha të asaj epoke. Fakti që kryqi tregon falje, shkon përtej barrierave kulturore, dhe një kapërcim të tillë duhet të ketë edhe mesazhi që kryqi përcjell.


Ne duhet që patjetër të mësojmë ta komunikojmë ungjillin përtej barrierave kulturore, në të njëjtën mënyrë që kanë mësuar edhe misionarët e huaj. Kisha ka nevojë që të ketë po këtë ndjeshmëri dhe disa prej po këtyre aftësive për ta arritur shoqërinë tonë laike. Ato kombe që prej kohësh janë konsideruar si kombe të krishtera, nuk mund të përshkruhen më si të tilla. Gjatë këtyre dekadave të fundit, këto kombe janë kthyer gjithnjë e më shumë në kultura post-të-krishtera. Kisha sot përballet me sfidën për ta komunikuar mesazhin e Krishtit në një kontekst ndërkulturor.

Me qëllim që ta komunikojmë Krishtin në mënyrë efikase tek një shoqëri laike, na duhet të pranojmë që po komunikojmë nga një kulturë kishtare, tek një kulturë laike. Ndoshta jemi duke komunikuar me persona nga e njëjta kulturë si e jona; por nëse kemi shpenzuar një pjesë të mirë të jetës sonë në kishë, atëherë kemi përfutur perceptimet, vlerat dhe, madje, edhe fjalorin e kishës. Një i krishterë dhe një jobesimtar mund të flasin të dy të njëjtën gjuhë, por i krishteri shpesh përdor terma kishtare të cilat janë të panjohura ose kanë një kuptim shumë ndryshe në kulturën laike. Kur ne e përdorim lirshëm zhargonin e krishterë me jobesimtarët, atëherë po ngremë disa barrierë komunikimi. Fjalë të tilla si “të shpëtuar”, “ungjilli” dhe “i vajosur”, për ne kanë kuptime që janë gjerësisht të pranuar, ndërsa për njerëzit që nuk i njohin mirë këto terma ato sjellin konfuzion. Jobesimtarët duhet të arrihen nëpërmjet fjalorit të tyre, jo fjalorit tonë.

Te Letra Drejtuar Kolosianëve 4:2-6, apostulli Pal shkroi: “Ngulmoni në lutje, duke ndenjor zgjuar në të me falënderim. Dhe duke u lutur në të njëjtën kohë edhe për ne, që Perëndia të na hapë neve një derë të fjalës, për të folur misterin e Krishtit, për shkakun e të cilit jam edhe i lidhur, në mënyrë që ta bëj të njohur, duke e folur siç duhet. Ecni me urtësi ndaj të jashtëmëve duke shfrytëzuar kohën. Fjala juaj të jetë gjithnjë me hir, e ndrequr me kripë, që të dini si duhet t’i përgjigjeni gjithsecilit”.

Pali shfaq një varësi të aktivitetit hyjnor kur vinte puna të procesit të ungjillëzimit. Ai iu kërkoj besimtarëve që t’i luteshin Perëndisë që të hapte një derë për mesazhin e tij dhe që gjithashtu Perëndia do ta ndihmonte ta bënte të qartë mesazhin, pra, ta ndihmonte të fliste ashtu siç duhej. Edhe pse ne varemi të Perëndia që Ai të hapë një derë për fjalën, duhet po ashtu të varemi tek Ai që të na ndihmojë për ta bërë të kuptueshëm mesazhin dhe të sillemi me urtësi kundrejt atyre që janë jashtë kishës.

Ne duhet të jemi profetizues, duke e shpallur me guxim e me anë të fuqisë së Frymës, lajmin e mirë për Jezusin. Por gjithashtu duhet që të flasim gjuhën e dëgjuesve tanë, duke pranuar bashkë me apostullin Pal se misterin e Krishtit duhet ta bëjmë të njohur tek të tjerët në mënyrë të qartë dhe me urtësi.



Termi “të jashtëmëve”, që përdori Pali, është goxha sqarues. Të gjithë kemi qenë në situata kur kemi qenë ne të jashtëmit. Ata të brendshmit kanë shakatë e tyre dhe shprehjet e tyre private. Ne nuk i kuptojmë dhe kështu na duket vetja të tepërt sepse kuptimet janë private. Por ne nuk duhet ta mbajmë privatisht mesazhin e Krishtit; përkundrazi, duhet ta bëjmë publik atë.

Jezusi përdorte gjithmonë ide dhe fjalor që mund të kuptoheshin nga njerëzit me të cilët ai takohej dhe me të cilat njerëzit mund të identifikoheshin. Në kohën e Dhjatës së Re, një nga barrierat më të mëdha kulturore ishte ajo midis hebrenjve dhe samaritanëve. E megjithatë, Jezusi depërtoi edhe përtej kësaj barriere.

Shëmbëlltyra e samaritanit të mirë erdhi si përgjigje ndaj pyetjes së një njeriu të ligjit, i cili tha: “Kush është fqinji im?”. Në fakt, pyetja e vërtetë që kishte ky njeri i ligjit ishte: “Kush *nuk* është fqinji im?”. Ai realisht dëshironte të dinte se kë *nuk* ishte i detyruar të donte si veten e vet.

Nga vetë shëmbëlltyra është e qartë se njeriu që u plaçkit ishte hebre. Ata të cilët e panë, por kaluan nga ana tjetër ishin edhe ata hebrenj, por samaritani u soll si një fqinj për burrin që ishte në nevojë. Njësoj siç tingëllon, samaritani thjesht u kujdes për burrin në rrugë për shkak se ishte aty. Dhe ky është fqinji ynë, pra, kushdo që është aty.

Çdo brez i ri është një grup njerëzish që ende nuk janë arritur. Fqinjët tanë, pra, njerëzit që janë aty, janë shumë ndryshe nga brezat që kanë kaluar. Kështu që duhet t'i arrijmë edhe ata.

Kur Jezusi po fliste me gruan samaritane tek pusi, ai përdori fjalor dhe ide të cilat ishin të kuptueshme për të. Ai e adresoi, në një mënyrë të qartë, problemin e mëkatit, por e bëri këtë gjë duke e mbajtur fokusin e bisedës tek nevojat dhe interesat e gruas. Bisedën e udhëhoqi Jezusi, por ai nuk e kontrollonte plotësisht atë. Ai iu përgjigj gruas, ashtu siç na nxiti Pali më sipër që të bëjmë edhe ne.


Në një rast, ndërkohë që unë dhe një miku im ishim duke ecur nëpër rrugët e Moskës, bëmë disa intervista me njerëz të ndryshëm. I prezantua Perëndinë një vajze, dhe ajo na u përgjigj: "Unë besoj te Perëndia, por nuk jam e sigurt që ai ka aq fuqi sa të zgjidhë problemet që ka Rusia. Në kishë nuk shkoj se atje shumica janë pleq, dhe ata nuk më lejojnë të vesh pantallona".

Ishte shqetësuese për mua që ekspozimi që kjo vajzë kishte pasur me ungjillin kishte pengesa për shkak se nuk ndihej se mund të shkonte në kishë ashtu siç ishte. Gjatë shumë ftesave për të pranuar Krishtin të cilat bëhen nga altari, kori këndon himnin "Kështu siç jam", por ndonjëherë ne presim që njerëzit të vijnë te Krishti sipas kushteve të kishës.

Si mund të komunikojnë në një mënyrë më të ndjeshme dhe më efikase besimtarët e krishterë me njerëzit që janë në një kulturë laikë? Unë do të sugjeroja tri gjëra: Të mësosh, të dëgjosh dhe të duash.

TË MËSOSH

Kaloni kohë duke menduar dhe duke studiuar fjalorin dhe konceptet e krishtera të cilat mund të jenë të huaja për personat laikë, dhe mësoni të përcillni të vërtetat e krishtera në gjuhën e tyre.



Prindërit e mi misionarë bënë gjithmonë shokë jobesimtarë dhe identifikoheshin në mënyrë efikase me njerëz që nuk kishin një sfond të krishterë. Në mënyrë që të sillemi me urtësi karshi të jashtëmëve, na duhet që t'i njohim dhe t'i kuptojmë ata. Dhe për

këtë, na duhet të shpenzojmë kohë me ta. Thirrja e parë që Jezusi iu bëri dishepujve të tij ishte thjesht që ata të mund të "rrinin me të" (Marku 3:14). Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i shohim njerëzit vetëm si shpirtra të përjetshëm pa i çmuar ata si individë.

TË DËGJOSH

Mos bëni vetëm predikime, por jepuni përgjigje pyetjeve. Mos i dominoni bisedat, por i udhëhiqni ato. Mos harroni nxitjen e apostullit Pal për t'iu "përgjigjur" të huajve. Pjetri u tha besimtarëve se duhet të "jini gjithnjë gati për mbrojtje ndaj kujtdo që ju kërkon fjalë për shpresën që është në ju, por me butësi e me druajtje" (1 Pjetrit 3:15).

TË DUASH

Thjesht i doni njerëzit. "Dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh" (1 Pjetrit 4:8) - madje edhe gafat kulturore. Gabimet kulturore falen nëse personi që i bën ato gabime shfaq dashuri të pastër.

Kumtimi i Krishtit përtej barrierave kulturore nuk është një alternativë për Kishën, por një domosdoshmëri, një porosi biblike. Te Kol.4:4-6, Pali e përdor dy herë fjalën "dei" në greqisht, e cila është një urdhërore e ashpër që do të thotë "duhet patjetër" ose "është e nevojshme". Pali tha se mesazhi i Krishtit duhet patjetër të thuhet qartë dhe ne duhet patjetër që t'i përgjigjemi me urtësi çdo personi të jashtëm.

Perëndia e ka vendosur Kishën në botë për të qenë dritë dhe kripë, pra për të ndikuar botën rreth nesh. Kushdo që është atje, duhet të arrihet me ungjillin. Kisha nuk duhet të jetë e izoluar nga shoqëria laikë, por të depërtojë në të, përmes pjesëmarrjes në veprën sovranë të Perëndisë, duke i thirrur njerëzit jashtë "nga terri në dritën e tij të mrekullueshme" (1 Pjetrit 2:9).



RANDY HURST, është drejtori për komunikimin për Misionet e Huaja të Asambleve të Perëndisë.

AIRITJA E NJË GJENERATE POST-MODERNE

Nga: **JOSH McDOWELL**

S Si ta arrijmë një brez post-modern? Te Letra e Parë drejtuar Thesalonikasve 2:2, apostulli Pal bën një deklaratë që është shumë e përshtatshme edhe për ditët e sotme: “Por, mbasi vuajtëm më parë dhe u keqtrajtuam siç e dini, në Filipi, morëm guxim në Perëndinë tonë të flasim ndër ju ungjillin e Perëndisë me shumë betejë”.

Në rast se mendoni se jeni përballur me konflikt në të kaluarën, atëherë mbërthehuni mirë. Konflikti do të dalë nga këto tri kriza.

NJË KRIZË KULTURORE

Ne jemi brezi i parë në këto 300 vjet, i cili po kalon një ndryshim të dukshëm kulturor. Teologu dhe filozofi Francis Schaeffer dikur ka deklaruar: “Ne nuk po jetojmë më në një kulturë judeo-kristiane; tani jetojmë në një kulturë post-judeo-kristiane”. Por ne nuk jetojmë më as në një kulturë post-judeo-kristiane; tani ne po jetojmë në një kulturë anti-judeo-kristiane.

Për vite me radhë i kemi stërvitur misionarët që të shkojnë në kultura të tjera dhe të ngrenë ura lidhëse me atë kulturë. Por, nëse nuk i trajnojmë njerëzit që të ngrenë ura lidhëse me këtë kulturë të re, atëherë nuk do të jemi aspak të efektshëm.

KRIZA E SË VËRTETËS

Jezusi tha: “Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta”. Por të rinjtë që janë në bashkësinë tuaj nuk e kuptojnë të vërtetën njësoj si ju.

Në kulturën tonë post-moderne, koncepti i të vërtetës ka pësuar një ndryshim rrënjësor. Në kohën tonë, na mësuan ta zbulonim të vërtetën. Por, në post-modernizëm, e vërteta objektive nuk ekziston. Dhe e vërteta nuk duhet të zbulohet; e vërteta tani duhet të krijohet. Çfarëdolloj gjëje që ju mendoni se është e vërtetë, është e vërtetë. Nuk ka rëndësi ajo që ka shkruar autori në libër. Çfarëdolloj gjëje që perceptoni ju nga libri, është po aq e vërtetë sa ajo që donte të thoshte autori.

Kur disa njerëz thonë: “Çdo gjë varet nga perceptimi”, ata në fakt duan të thonë këtë: “Sido që ta kesh perceptuar atë që ndodhi, ajo është po aq e vërtetë, sa edhe ajo që ndodhi realisht”. Ja pse njerëzit mund ta rishkruajnë historinë.

Gjithashtu të rinjtë bërtasin: “Mos m’i impono mua vlerat e tua: lërmë ta përcaktoj vetë se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe për veten time”. Për më tepër, arsyeja numër një sot se përse njerëzit mendojnë se Krishterimi është i rremë, është për shkak se ai pretendon se është i vërtetë dhe shpall se të gjitha fetë e tjera janë të rreme.

Shumë pastorë nuk predikojnë rreth doktrinës për shkak se thonë që ajo është përçarëse. Ti flet për të vërtetën dhe ajo është përçarëse. Përkundrazi, pastorët thonë: “Kemi plot lavdërim dhe adhurim në kishë”.

Por unë iu them: “Në rast se nuk flisni për doktrinën, si do ta dini se kë po adhuroni?”. Nuk keni si ta dini. Ne duhet të japim mësim të vërtetën, përndryshe do të adhurojmë një pjellë të imagjinatës sonë.

Para dhjetë vitesh, dikush do më thoshte: “Unë thjesht nuk mund të besoj te Jezu Krishti”. Kështu unë do t’i tregoja këtij personi, provat për ringjalljen e Jezusit dhe do t’i hidhja poshtë të gjitha argumentet që kishte ai.

Pas dy orësh, do ta pyesja: “A dëshiron t’i besosh Krishtit si shpëtimtarit tënd?”. Dhe ai do të më përgjigjej: “Po”. Sot, ulem me të rinjtë dhe iu paraqes provat që tregojnë se Krishti është Perëndi.

I pyes: “A doni ta pranoni Krishtin?”. “Ncuq!”.

Pse? Sepse e vërteta nuk është më problemi tani.

Shpeshherë i pyes të rinjtë: “A besoni se është gabim të gënjeshtë?”.

“Po,” më përgjigjen. “Po, pse?” i pyes unë. “Nuk e di,” përgjigjen ata.

Kam thirrur rreth 209 të rinj të krishterë që të dalin para kishave të tyre dhe i kam pyetur: “Në qoftë se del një situatë ku, në rast se gënjeni nuk do të kishte asnjë pasojë për ju, a do të gënjenit?”.

Nga këta 209 të rinj, 204 prej tyre u përgjigjen menjëherë: “Po”. Nga ata 5 të tjerët, një vajzë tha që do të lutej më parë. Një nga djemtë tha: “Qenka pyetje e vështirë, por nuk mendoj se do të gënjeja”.

Nga 209 persona, vetëm 3 thanë: “Jo”.

Ne sot kemi një brez që e ka
humbur aftësinë për të bërë
dallimin mes të drejtës dhe të
gabuarës për shkak se e ka humbur
të vërtetën rreth personit,
karakterit dhe natyrës së
Perëndisë.

Pastaj i mora këta 209, iu shtova edhe 104 të tjerë, dhe i çova një hap më tej, duke i pyetur: “A besoni se gënjeshttrat janë gabim?” 310 vetë thanë menjëherë: “Po”.

Pra, e shihni, në këtë kulturë të re, tek të rinjtë nuk ka pothuajse asnjë lidhje reciproke mes besimit dhe sjelljes. 98.5 për qind thanë se do të gënjenin; 98.5 për qind thanë se gënjeshttra është e gabuar. Kjo gjë është një nga pikëllimet më të mëdha të atyre që shërbejnë me të rinjtë, madje edhe tek ata që janë më frymërorët. Këta të rinj, dëgjojnë një predikim në lidhje me seksin, dhe i drejtohen altarit ku pendohen dhe vajtojnë. Pastaj, pas gjysmë ore, njëri prej këtyre të rinjve është në shtrat me të dashurën e tij, dhe as që e bën lidhjen mes sjelljes së tij dhe gjërave që beson.

Pastaj, i pyeta këta 313 të rinj: “Përse është gabim të gënjejme?” Shumica e tyre u përgjigj: “Sepse prindërit e mi më kanë mësuar se është gabim”. Mendoni pak rreth kësaj. Nëse thoni se diçka është gabim vetëm sepse prindërit tuaj ju kanë mësuar se është gabim, atëherë sapo keni justifikuar të gjitha mizoritë dhe ligësitë në histori. Sapo justifikuat holokaustin dhe vrasjen e 6 milionë hebrenjve për shkak se prindërit nazistë iu mësuan fëmijëve të tyre se kjo ishte një gjë e mirë. Pastaj i pyes: “Si jua kanë mësuar prindërit këtë?”. Pothuajse 50 për qind e këtyre fëmijëve të krishterë nuk vazhdojnë dot përtej kësaj pyetjeje. 55 për qind thanë: “Sepse Bibla thotë se është gabim të gënjeshtrosh”. Vazhdova t’i pyes edhe më tej: “Përse thotë Bibla se gënjeshttra është gabim?”. Vetëm tre prej tyre mund t’i përgjigjeshin pyetjes.

Ne kemi rritur një brez fëmijësh që jetojnë në legalizëm. Urdhërimet, madje edhe Dhjetë Urdhërimet, nuk përmbajnë autoritetin moral për të vendosur se përse diçka është e mirë apo e gabuar. Ato thjesht shpallin që diçka është e drejtë apo e gabuar. Të rinjtë duhet të kuptojnë se *përse* gjërat janë të drejta dhe të gabuara. Bibla deklaron se është gabim të gënjejme sepse personi, karakteri dhe natyra e Perëndisë është e vërtetë. Vrasja është e gabuar, sepse Perëndia është jetë; urrejtja është e gabuar, sepse Perëndia është dashuri; dhe padrejtësia është e gabuar, sepse Perëndia është i drejtë. Sot kemi një brez që e ka humbur aftësinë e tij për të bërë dallimin mes të drejtës dhe të gabuarës, për shkak se e ka humbur të vërtetën rreth personit, karakterit dhe natyrës së Perëndisë.

KRIZA E TOLERANCËS

Toleranca sot është virtyti më i rëndësishëm në 85 për qind të kulturave të botës. Por koncepti i tolerancës ka pësuar një ndryshim tërësor. Për

NDRYSHIME BREZASH

BREZI I RITJES DEMOGRAFIKE	BREZI X POST-MODERNIST*
1. Brezi unë	Brezi ne
2. Jeto për të punuar	Puno për të jetuar
3. Botëkuptimi iluminist	Botëkuptimi post-modernist
4. Institucionet	Marrëdhëniet
5. E vërteta e pohuar	E vërteta relative
6. Ekselencia	Originaliteti
7. Rritja	Komuniteti
8. Të vetmuar	Më vete
9. Suksesi	Tërësia
10. Agresivë	Pasivë
11. Shpresues	Cinikë
12. Sfond judeo-të krishterë	Relativizëm moral dhe filozofik
13. Punë të mira	unë me paga të ulëta
14. Lëvizja “hipi”	Autostrada e informacionit
15. Vënë në dyshim autoritetin	E shpërfillin autoritetin
16. Të mirat materiale janë me vlerë	Integriteti është me vlerë

- Përshtatur nga artikujt me autor Kevin Ford, “Brezi Im” (“My Generation”), Intervarsity, Dimër 94-95, 3-7; dhe nga Dieter Zander, “Ungjilli i Brezit X” (“The Gospel for Generation X”), Leadership, Pranverë 1995, 37-42.

*Sqarim i përkthyesit - Brezi i Rritjes Demografike (Boomer Generation) në SHBA është brezi i lindur rreth viteve 1945 - 1960. Ndërsa Brezi X (Generation X) është brezi i lindur rreth viteve 1965 - 1980.

mua dhe për ju, tolerancë do të thotë: “të durosh ose të pajtohesh me dikë apo me diçka, të cilin jo domosdoshmërisht e pëlqen”. Por sot, kuptimi i saj është: “Të gjitha vlerat, besimet, stilet e jetesës dhe pretendimet për të vërtetën janë të barabarta”. Filozofi Aram Hair, është shprehur kështu: “Toleranca është një besim që thotë se pikëpamjet dhe opinionet e të tjerëve janë po aq të vërteta sa edhe tuajat”. Të krishterët janë kthyer në njerëzit më intolerantë në botë për shkak se themi që Jezu Krishti është “rruga, e vërteta dhe jeta”. Çdo gjë që predikoni, shkon në kundërshtim me virtytin më të rëndësishëm të kulturës.

Deri para rreth 7 vitesh, në rast se do të bëja një deklaratë rreth hyjnisë së Krishtit, ringjalljes, apo ekzistencës së Perëndisë, do të më ndërprisnin ose do të më sfidonin rreth përmbajtjes së asaj që kisha deklaruar. Ndërsa tani, kur bëj një deklaratë rreth hyjnisë së Krishtit, ringjalljes apo seriozitetit të Shkrimit të Shenjtë, njerëzit reagojnë duke thënë: “Me çfarë të drejte po i thua këto gjëra? Me ç’të drejtë e gjykon jetën morale të tjetrit?”. Madje e vërteta, sot, as nuk është një çështje. Në fakt, vargu më i cituar sot, edhe nga të rinjtë e krishterë, është: “Mos gjykoni, që të mos gjykoheni”.

PËRGJIGJA

Si t’ia bëjmë? Tek 1 Thesalonikasve 2:7-8, Pali bën një deklaratë të thellë: “Përkundrazi, qemë të butë në mesin tuaj, ashtu si mëndesha kujdeset me ngrohtësi për fëmijët e saj; kështu, duke pasur një dashuri të madhe ndaj jush, na pëlqeu t’ju përçojmë jo vetëm ungjillin e Perëndisë, por edhe vetë shpirtat tanë, sepse na u bëtë të dashur”. Ju

RREGULLA DHE SFIDA TË REJA PËR TË RINJTË E SOTËM

Pikëpamja e brezit të kohëve moderne

1. Ajo që vlen janë marrëdhëniet personale, jo institucionet.
2. Procesi është më i rëndësishëm sesa produkti.
3. Larmia mes njerëzve kërkohet në mënyrë agresive.
4. Të kënaqesh me njerëzit dhe të shijosh mundësitë e jetës është më e rëndësishme sesa produktiviteti, përfitimi apo arritja e qëllimeve.
5. Ndryshimi është gjë e mirë.

6. Zhvillimi i karakterit është më vendimtar sesa arritja apo përmbushja.
7. Nuk mund të vareni gjithmonë tek familja juaj për t'ju gjendur pranë, por ajo është shpresa juaj më e mirë kur vjen puna për mbështetje emocionale.
8. Secili individ duhet të marrë përgjegjësitë e veta për botën e tij / botën e saj.
9. Kurdoherë që është e nevojshme, merrni kontroll dhe përdoreni me zgjuarsí.
10. Mos e harxhoni kohën kot duke kërkuar gjëra absolute; nuk ka.

11. Një person mund të sjellë ndryshim në botë, por jo aq shumë.
12. Jeta është e vështirë dhe pastaj vdesim; por për shkak se është e vetmja jetë që kemi, do të bënim mirë ta duronim, ta përmirësonim dhe ta shijonim në maksimum.
13. E vërteta frymërore mund të marrë shumë forma të ndryshme.
14. Shpreheni tërbimin tuaj.
15. Teknologjia është aleati ynë i natyrshëm.

- **GEORGE BARNA**, *Brezi Tjetër: Rregulla të Reja, Sfida të Reja (Regal, 1995, 107-116).*

lutem, lexojeni edhe njëherë këtë: "t'ju përçojmë jo vetëm ungjillin e Perëndisë, por edhe vetë shpirtrat tanë". Ata nuk e fituan atë brez vetëm duke përçuar ungjillin, por duke përçuar vetë shpirtrat e tyre. Për ta fituar këtë brez, ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë. Na duhet të përçojmë edhe vetë shpirtrat tanë bashkë me ungjillin.

Postmodernistët besojnë se nuk ekziston asnjë botëkuptim, siç është botëkuptimi i krishterë, i cili të jetë i vërtetë për të gjithë. Deri para rreth 5 - 8 vitesh, apeli i të krishterëve drejtuar të rinjve, në lidhje me këto botëkuptime, ishte ky: Adoptoni botëkuptimin e krishterë, sepse ai është i vërteti. Por kjo nuk funksionon më tani, sepse të rinjtë besojnë që të gjitha të vërtetat janë njësoj të barabarta. Në qoftë se thoni se botëkuptimi juaj është më i mirë se një botëkuptim tjetër atëherë do t'ju quajnë intolerant dhe fanatik. Por, si t'ia bëjmë që të rinjtë të kenë dëshirë për botëkuptimin e krishterë dhe të duan ta njohin personalisht Jezun Krishtin?

Tetëdhjetë për qind e të rinjve që bëhen të krishterë sot, nuk bëhen të krishterë për shkak se është i vërtetë krishterimi. Ata bëhen të krishterë për shkak se kjo është gjëja më e mirë që iu doli përpara. Në qoftë se nuk i çojmë tek e vërteta e fjalës së Perëndisë, në momentin që do t'iu dalë përpara diçka tjetër që ata mendojnë se është më e mirë, ju nuk keni për t'i parë më në grupin tuaj të të rinjve. Si të bëhemi bindës, me qëllim që të bëhemi të besueshëm? Duke u bërë dritë edhe kripë, si dhe duke përçuar shpirtrat tanë.

Ne duhet të zhvillojmë komunitetin. Mos harroni se po i shërbejmë një prej brezave më të lënduar në histori, pra, atyre të rinjve që kanë përjetuar familje dhe marrëdhënie të prishura. Ajo kishë që mund të krijojë *koinonian* e Dhjatës së Re që përshkruhet te Gjoni 13:17, pra, një dashuri për njëri-tjetrin, ajo do të jetë kisha që do të mbushet më plot. Ky do të jetë themeli për ungjillëzimin.

Ne duhet të kemi dhembshuri. Dhembshuria është një nga mjetet më fantastike që kemi për t'i arritur njerëzit me ungjillin e Krishtit. Dhembshuria e krishterë u tregon të rinjve që si ne, ashtu edhe

ungjilli jemi të besueshëm. Çdo kishë që nuk po arrin (ndihmon) të vejat, jetimet, të pastrehët dhe të varfrit, nuk po ecën në vullnetin e Perëndisë.

Ne duhet të çmojmë mjedisin. Në epokën e sotme, me brezin e sotëm, mjedisi është një nga faktorët më vendimtarë. Dhe një nga mënyrat më të mira për të pasur ndikim tek të rinjtë është duke u treguar atyre shqetësimin tuaj për krijimin e Perëndisë. Kjo do të na japë besueshmëri për t'i mësuar ata rreth Jezut Krishtit.

Ne duhet të kemi martesë dhe familje të forta. Dëshira më e madhe e 15 dhe 17 vjeçarëve është një martesë e lumtur dhe një jetë familjare e lumtur. Edhe martesat, edhe familjet tona do të na japin besueshmëri. I dashur pastor, cili është reputacioni yt në kishën tënde? A e do bashkëshorten tënde dhe a kalon kohë me fëmijët e tu? Në qoftë se jo, bën mirë ta shqyrtosh stilin tënd të jetesës. Mund të predikosh sa të duash dhe çfarë të duash; por në rast se të rinjtë nuk e shohin të vërtetën e Jezut Krishtit të transformuar në martesën tënde, ata nuk do t'ia vënë veshin të vërtetës.


Platforma (katedra e predikimit) më e fuqishme, sot për sot, për të ndikuar tek të rinjtë është roli i babait. Marrëdhënia që keni me fëmijët tuaj është një nga gjërat më të fuqishme, më të shkëlqyera, që keni për të arritur këtë brez që po rritet. Për cilindo pastor që nuk shpenzon kohë me fëmijët e tij, do të jetë e vështirë që të jetë efikas në shërbesën e tij karshi brezit të ardhshëm.

I dashur pastor, për të arritur këtë brez, të duhet që të mësosh të vërtetën, të duhet që ta jetosh të vërtetën. Por, për ta arritur këtë brez, na duhet të përçojmë shpirtrat tanë përmes komunitetit, martesave tona, përmes fëmijëve tanë dhe përmes dhembshurisë.



JOSH McDOWELL, është një autor i mirënjohur dhe specialist për të rinjtë. Ai ka udhëtuar me Institutin Jeta e Re për më shumë se 30 vjet duke adresuar nevojat dhe problemet e të rinjve.

**BREZI I SOTËM PO RRIKET NË DISA
RRETHANA QË JANË TË NDRYSHME NGA
ÇDO BREZ TJETËR MË PARË.**



Predikimi Biblik

PËR NJË BREZ TË RI

Nga: **MICHAEL VANDOREN**

Mënyra më e mirë për ta arritur brezin e sotëm, është nëpërmjet të njëjtës mënyrë që arrihet çdo brez apo çdo kulturë, pra, përmes të vërtetës së Fjalës së pandryshueshme të Perëndisë. Kjo fjali e fundit ka të bëjë me përmbajtjen e asaj që predikojmë; mënyra se si e predikojmë Fjalën është një çështje tjetër. Pastorët nuk ndajnë të gjithë të njëjtin perceptim rreth predikimit biblik, dhe jo të gjithë dinë se si t'i transmetojnë një bote të ndryshueshme, disa të vërteta të pandryshueshme.

SHPESH EKUILIBRI ËSHTË REALITETI

Brezat ndajnë gjëra të përbashkëta me brezat pararendës, por ata kanë gjithashtu edhe dallimet e tyre. Nuk mund ta mohojmë vlefshmërinë e të kaluarës apo nevojën për t'u përshtatur me të tashmen dhe të ardhmen. Kishat e suksesshme janë ato kisha të cilat me urtësi i marrin gjërat me vlerë nga e kaluara dhe i ripaketojnë ato për nevojat e të tashmes.

KUSH PO NA DËGJON?

Ekzistojnë shumë mënyra për ta përgatitur predikimin duke u orientuar drejt dëgjuesit. Një nga këto mënyra është të kuptojmë se cila është audienca që kemi përpara nesh. Në vijim, merrni në konsideratë dy karakteristikat e brezit të ri dhe si lidhen ato me predikimin.

Ky brez është dëshpërimisht i humbur. Çdo brez ka jetuar në mëkat dhe ka pasur nevojë për ungjillin, por apostulli Pal thotë se në ditët e fundit do të vijë kohë të tmerrshme. Ai e përshkruan këtë paperëndishmëri te kapitulli 3 në Letrën e Dytë Drejtuar Timoteut. Ne po jetojmë në ditët e fundit. Brezi aktual po rritet nën ca rrethana që janë ndryshe nga çdo brez tjetër më parë. Numri i lartë i divorceve ka lënë shumë plagë emocionale dhe mosbesim tek shumë fëmijë. Numri i vetëvrasjeve abuzimi me drogën, kriminaliteti, imoraliteti dhe

mosrespektimi për autoritetin vazhdon të rritet, duke e shqepur stofin moral me të cilin është mbështjellë shoqëria jonë. Njerëzve iu mungon vetëkontrolli, si edhe dëshira për të qenë të përgjegjshëm. Shumica as nuk e kupton se çfarë do të thotë që të kesh përkushtim ndaj Perëndisë, kishës, bashkëshortit, bashkëshortes apo punës. Një pjesë e mirë e këtij brezi është rritur jashtë kishës dhe nuk ka pasur shembuj të mirë.

Edhe pse ekzistojnë disa karakteristika pozitive nga brezi i ri, ende jetojmë në një gjeneratë e cila, në mënyrë të dëshpëruar, ka nevojë të dëgjojë shpalljen e Biblës me dashuri dhe me një guxim të shenjtë. Ka predikues të cilët në të vërtetë nuk po shpallin Shkrimin. Përkundrazi, ata po shpallin disa tema që kanë përvijime komplekse ose po e interpretojnë tekstin në mënyrë simbolike, për shkak se nuk shpenzojnë kohë të mjaftueshme për ta studiuar siç duhet atë. Nëse shpresojmë që ta arrijmë me ungjillin e Krishtit këtë brez të lënduar, na duhet ta mbajmë në katedër interpretimin dhe zbatimin e Fjalës së Perëndisë.

Një tjetër karakteristikë e brezit aktual, e cila ndikon tek predikimi, është mënyra se si dëgjon ky brez. Personat që bëjnë pjesë në këtë brez janë të aftë që të menaxhojnë një numër të madh informacionesh dhe t'i procesojnë ato nga burime të shumëfishta. Ata lundrojnë në internet me një kërkesë gjithnjë e më tepër në rritje për të "thithur" informacion.

Një anketim i kohëve të fundit nga revista "PC" tregoi se 94 për qind e lexuesve të saj e përdornin rrjetin (internetin) për të marrë të dhëna rreth një produkti apo një shërbimi.¹ Sot njerëzit mund të arrijnë e të shohin me qindra kanale që transmetohen nëpërmjet satelitëve. Po ashtu, ata mund të lexojnë shumë revista e libra, si edhe mund të dëgjojnë podcaste. Shumë njerëz mbajnë

me vete telefona celularë dhe kompjuterë. Ata e duan informacionin në çast dhe fillojnë të mërzhiten me predikimet që paraqesin vetëm një ide kryesore e që përcillen pa emocion nga predikuesi.

Shikoni pak dhe analizoni emisionet e lajmeve dhe programet më të ndjekura të televizioneve dhe do të zbuloni se ekzistojnë disa skenarë të shumëfishtë brenda një programi, të cilët ndërhyjnë në momente të ndryshme gjatë emisionit. Dëgjuesit e sotëm ushqehen me një dietë të rregullt me informacion të ndryshueshëm; në fakt, kjo gjë ka arritur pikën e të qenit një kushtëzim kulturor. Një nga efektet anësore kur shohim televizor dhe përdorim internetin është një nivel më i shkurtër i përqendrimit tonë. Kjo nuk do të thotë se i gjithë predikimi ynë duhet të zvogëlohet sa koha që duhet nga njëra reklamë tek tjetra, por që ekzistojnë disa kufizime mendore. Pas këtyre kufizimeve, njerëzit nuk do t'ju kushtojnë më vëmendje. Është mirë që pastorët të kenë pika kryesore të cilat zgjasin nga 5 deri në 9 minuta, në varësi të gjatësisë së predikimit.

Komentet më poshtë janë disa përpjekje të ekuilibruara për ta rigjallëruar predikimin tuaj. Disa prej tyre janë gjëra që ju i bëni tashmë; të tjerat do të kërkojnë ndryshime nga ana juaj.

ÇFARË PREDIKOJMË: NJË SHEMBULL I PREDIKIMEVE BIBLIKE NË FORMË TREGIMESH

Një nga pedagogët e mi të predikimit dikur më ka thënë se është e vështirë të gjesh predikues të cilët me të vërtetë bëjnë predikime biblike. Kjo nuk duhet të jetë kështu. Roger Van Harn vëzhgon se: “predikimet bëhen nga tekstet biblike, por jo rreth teksteve biblike”.² Më qëllon ndonjëherë që të dëgjoj ndonjë predikues që deklaron në mënyrë shfajësuese: “Predikimi i sotëm nuk është shumë homiletik”. Si pedagog i homiletikës - artit dhe teologjisë së predikimit - fytyra më ndrin dhe ulem më afër cepit të karriges sime duke pritur që të dëgjoj një predikim, i cili me të vërtetë të predikojë tekstin biblik. Zakonisht, shpresa ime shpërblehet ndërkohë që predikuesi shpalos vargjet, duke i shpjeguar ato dhe duke i aplikuar për ditët e sotme.

“Homiletika e çdonjërit prej nesh” varet nga arti dhe teologjia e predikimit që kemi marrë si mësim secili nga ne, dhe ky art ka ndryshuar gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Pika e fillesës nuk është: “Çfarë mund të them unë rreth këtij pasazhi?”, por përkundrazi: “Çfarë po përpiqet të thotë ky pasazh?”.

PËR PREDIKIME TË FUQISHME NGA BIBLA

1. **Predikoni pasazhe të Biblës, jo vetëm temat që dalin nga pasazhet.**
2. **Mbusheni me lutje përgatitjen për predikimin ndërkohë që shpjegoni në mënyrë kritike tekstin dhe jetën e përditshme.**
3. **Aftësojini dëgjuesit që të shohin se si i adresohet Fjala e Perëndisë botës së tyre, dhe aftësojini ata që të reagojnë ndaj asaj Fjale.**
4. **Bëni një strukturë të qartë dhe logjike bashkë me një rrjedhë narrative të ideve.**
5. **Siguroni informacione interesante sipas epokës së informacionit ku jetojmë.**
6. **Përdorni me raste median (video, audio) si shtesë për ta plotësuar idenë e mesazhit.**
7. **Jini të vërtetë, të përshtatshëm dhe të lidhur me bashkësinë.**
8. **Njerëzit kanë një mendje, një vullnet dhe emocione. Adresojini të tria këto në predikim.**
9. **Mos kini frikë që t’u bëni thirrje njerëzve të pendohen dhe të shenjtërohen, sipas Biblës.**
10. **Mos bëni kompromis midis doktrinės së shëndoshë biblike dhe modës së momentit apo përvojave të përhapura aktualisht tek njerëzit.**
11. **Aktivizojini njerëzit që të përfshihen në ungjillëzim dhe në shërbesa të tjera.**
12. **Duajini dëgjuesit tuaj.**

– MICHAEL VANDOREN, D.Min., Lakeland, Florida



Shumica e pedagogëve bashkëkohorë të artit dhe teologjisë së predikimit thonë se na duhet t'i kthehemi përsëri predikimit narrativ dhe ta lejojmë formën e tekstit që të skicojë strukturën e predikimit. Shembujt biblikë dhe shembujt e kishës së hershme tregojnë se predikimi ishte narrativ (në formë tregimi). Vetë Bibla është si një tregim, pra, nuk është një bashkësi e përcaktuar temash. Perëndia e di mënyrën më të mirë për të komunikuar. Pentekostalët e hershëm bënë predikime në formë tregimi, sepse nuk kishin marrë arsimim formal në seminare. Autori Don Wardlaw, bashkë me gjashtë kontribuesit e tjerë të librit me titull: "Të predikosh sipas Biblës" (*Preaching Biblically*), i mëshojnë fort idesë së formave të predikimit të cilat vijnë nga tekstet biblike.³

Nuk na duhet gjithmonë që të ecim varg pas vargu, por idetë kryesore të pasazhit duhet të jenë idetë kryesore të predikimit. David Buttrick iu jep mësim pastorëve se si të shkruajnë strukturën e përmbajtjes së një pasazhi, të rendisin çdo element kryesor dhe pastaj t'i zhvillojnë ato në mënyra të ndryshme. Ai vë në dukje se predikimet me tema të caktuara janë si një foto çasti e zmadhuar e një pasazhi, ndërsa pasazhi është më shumë si një fotografi në lëvizje, pra, një film.⁴ Dëgjuesit tanë në të vërtetë duan filmin.

Pasazhet e Shkrimit janë kopshte të mbushura me të vërteta, dhe jo lule të veçuara. Ato janë si tavolina gostie ku kisha mund të ngopet, dhe jo vakte me vetëm një pjatë. Përse ta katandisim

tekstin vetëm në një temë kur ai mund të ketë një shumicë të vërtetash që përpiqet t'i përcjellë. Në rast se Fjala e Perëndisë mund ta shprehë vetveten në një paragraf 30 sekondash, atëherë duhet të jemi në gjendje që ta përsërisim atë në një predikim 30 minutash. Kur e thjeshtojmë Fjalën e Perëndisë në tema, mund të jemi duke e kufizuar mesazhin që Perëndia dëshiron të komunikojë përmes një fragmenti të Shkrimit dhe mund të mos e lejojmë Frymën e Shenjtë, pra, Atë që ka frymëzuar çdo varg, që të flasë përmes tekstit. Një nënprodukt i kësaj përqasjeje është se njerëzit nëpër kishat tona nuk e njohin apo nuk e kuptojnë realisht Fjalën e Perëndisë, dhe ata bëhen të cenueshëm nga ana frymërore. Unë nuk po rekomandoj zhdukjen e plotë të predikimeve me tema, por po pohoj besimin tim se ato duhet të jenë më të rralla.

Nuk është vetëm struktura e predikimit ajo që e përcakton predikimin biblik, por edhe ajo që arrin predikimi është e rëndësishme. William Thompson vëren: "Predikimi biblik ndodh atëherë kur dëgjuesit aftësohen për të parë se si i adresohet Fjala e Perëndisë botës së tyre, njësoj si botës që paraqitet në Bibël, si edhe kur aftësohen për të reaguar ndaj asaj Fjale".⁵ Mesazhet tona duhet t'iu bëjnë thirrje njerëzve për t'u identifikuar me atë që Perëndia po thotë në një fragment dhe të reagojnë ndaj tij.

Ne jemi duke predikuar në një epokë të dëshpëruar e të plagosur; në një epokë që ka nevojë për preken e dashur dhe shëruese të predikimit të patundur e biblik. Fjala ka fuqi; le ta predikojmë Fjalën.

SHËNIME

1. Ziff Davis, Media Online News 14 Mars 2000.
2. Roger Van Harn, Të drejtat e katedrës (*Pew Rights*) (Grand Rapids: Eerdmans Publishing Co., 1992), 69.
3. O. Don Wardlaw, ed., Të predikosh sipas Biblës (*Preaching Biblically*) (Philadelphia: Westminster Press, 1983), 11–25.
4. David Buttrick, Rreth Homiletikës: Lëvizjet dhe Strukturat (*Homiletic: Moves and Structures*) (Philadelphia: Fortress Press, 1987), shih veçanërisht kapitujt 1-3.
5. O. William Thompson, Të predikosh sipas Biblës (*Preaching Biblically*) (Nashville: Abingdon Press, 1981), 10. Për më shumë rreth kësaj teme shih gjithashtu Calvin Miller, Predikimi në Sheshin e Pazarit (*Marketplace Preaching*) (Grand Rapids: Baker Book House, 1995).



MICHAEL VANDOREN, D.Min., ka dhënë mësim disa lëndë rreth predikimit në departamentin e shërbesave praktike në Kolegjin Juglindor të Asambleve të Perëndisë në qytetin Lakeland, Florida, për 17 vjet. Aktualisht, ai është i përfshirë me punë ungjilëzuese.

HAPAT

drejt

FALJES

Nga: GEORGE O. WOOD





Dhe kur qëndroni duke u lutur,
nëse kení diçka kundër ndokujt, faleni,
që edhe Atí juaj që është në qiejt,
t'ju falë mëkatet tuaja. Marku 11:25

**Jeta është plot me lëndim, por Jezusi është plot me shërim.
Askush nuk i shpëton dot lëndimit!**

Si vjen lëndimi?

TË IDENTIFIKOJMË BURIMET E LËNDIMEVE TONA

Kush ju ka lënduar? A ishte vallë një nga prindërit, dikush nga familja, bashkëshorti a bashkëshortja, fëmijët, miqtë, ndonjë anëtar i bordit apo i bashkësisë? Sa më e ngushtë që të jetë marrëdhënia, aq më i thellë është lëndimi.

Bashkëshortja e shkrimtarit të madh rus, Leon Tolstoi, ka thënë këto fjalë në lidhje me bashkëshortin e saj: “Ata që do t’i shkruajnë biografinë atij, do të tregojnë se si i ndihmoi punëtorët që të mbartnin kovat me ujë, por askush nuk ka për ta mësuar ndonjëherë, se ai nuk e la as një minutë gruan e tij të pushonte, si edhe që kurrë, për 32 vite, nuk i dha një gotë ujë fëmijës së tij apo të shpenzonte 5 minuta me të, tek krevati, që të më lejonte mua të pushoja pakëz nga të gjitha punët e mia”.

Shërbestarët nuk janë imunë ndaj lëndimeve që shkaktajnë të tjerët. Dhe disa prej bashkëshorteve, madje edhe ato të shërbestarëve, mund të identifikohen me komentet e bëra nga zonja Tolstoi.

Por njerëzit gjithashtu mund të lëndojnë edhe veten e tyre.

Para shumë vitesh po qëndroja në buzë të Kanionit të Madh (Grand Canyon). Nga shtrati i kanionit ngrihej një ishull prej shkëmbi me të njëjtën gjatësi sa vendi ku po qëndroja unë, i cili ndodhej rreth 0.5 - 1 metër largësi. Për shkak të sipërfaqes së tij të sheshtë, me kalimin e kohës, njerëzit kishin hedhur monedha metalike mbi ishull. Papritur, një fëmijë 6 vjeçar doli me vrap nga turma e njerëzve, kërcëu mbi këtë ishull dhe filloi t’i mbledhte monedhat e t’i fuste në xhep. Bashkë me të tjerët, edhe unë u ktheva në një spektator të paralizuar nga frika për sigurinë e këtij fëmije. Nëna e tij bërtiti me të madhe: “Xhoni, kthehu këtu!”. Me xhepin plot me monedha, dhe pa asnjë hezitim, ai kërcëu menjëherë në anën ku po qëndronim të gjithë.

Më vonë po mendoja: “Po sikur t’i kishte rrëshqitur këmba kur u hodh? A do të ishte nëna e tij në gjendje t’ia falte vetes që kishte pasur atë reagim instinktiv e që nuk priti sa të vinte një ndihmë e specializuar për ta larguar të birin nga ai vend i rrezikshëm?”.

Të falësh të tjerët mund të jetë më e lehtë sesa të falësh vetveten. Por ndoshta ndihemi gjithashtu sikur Perëndia na ka shkaktuar lëndime ose se Ai ka lejuar disa lëndime të na vijnë në jetë.

Në fillimet e shërbesës së David Wilkerson, një miku i tij pastor ishte duke dalë me makinë nga rrugica e shtëpisë së tij dhe shtypi fëmijën e vet 3

vjeçar. David Uilkerson e pati shumë të vështirë dhe luftoi me Perëndinë se si e kishte lejuar Ai që kjo t’i ndodhte mikut të tij. Dëshpërimi i tij ishte aq i madh, sa pothuajse e shtyu ta linte shërbesën dhe përkushtimin për t’i shërbyer Krishtit me efikasitet.

ÇMIMI I MOSFALJES

Shumë rrallë e diskutojmë çmimin e lartë që ka mosfalja, por merrni në konsideratë pasojat kur i ushqeni ofendimet:

- Frytet e Frymës gradualisht largohen.
- Indiferenca ose urrejtja i zë vendin dashurisë.
- Hidhësia ose depresioni i zë vendin gëzimit.
- Ankthi i zë vendin paqes.
- Gjaknxehësia i zë vendin durimit.
- Zemërimi ose mospërfillja i zë vendin mirëdashjes.
- Ligësia ose qëndrimi hakmarrës i zë vendin mirësisë.
- Natyra kërkuese i zë vendin zemërbutësisë.
- Dorëheqja nga përgjegjësitë i zë vendin vetëkontrollit.

Kur nuk falim, e kemi shumë të lehtë t’ia vëmë fajin dikujt tjetër për gjendjen ku ndodhemi. Kur falim, heqim dorë nga përgjegjësia jonë për të kontrolluar reagimet tona.

Basilea Schlink, themeluese e komunitetit karizmatik luteran të Murgeshave Ungjillore të Marisë në Darmshtad të Gjermanisë, tregon historinë e Kopshtit të Kumbullave në librin e saj me titull “Realitetet”.

Murgeshave iu nevojitej prona që ndodhej pranë komunitetit të tyre, me qëllim që të zgjeronin shërbesën që kishin ndërmarrë, por pronarja e shtëpisë ngjitur refuzonte ta shiste. Murgesha, e cila u përpoq që të negocionte për blerjen, nuk arriti dot ta kalonte derën kryesore të pronares.

Një ditë, stërnipi i pronares u takua me murgeshën tek dera dhe e futi brenda. Kur u fut në dhomën e të zonjës së shtëpisë, ajo kuptoi se përse po hasnin me probleme për blerjen e pronës. Dhoma ishte e tejmbushur me mobilie të trashëguara, aq sa mund të kompletonte një shtëpi, dhe shumica e tyre ishin të vjetruara. Njëra nga dhomat kishte gati 13 dyshekë që ishin vënë stivë njëri mbi tjetrin, dhe duheshin shkallë për të arritur atë që ishte në majë.

Ndërkohë që murgeshat nisën të luteshin, Zoti filloi të vepronte në zemrat e tyre, me qëllim që ato ta ftonin Atë të gjykonte jetët e tyre për sa i përket asaj që ato shihnin në jetët e të tjerëve. Ato sigurisht që nuk kishin pasuri të paluajtshme për të menaxhuar, por i kishin disa gjëra sekrete



pas të cilave ishin shumë të lidhura: ndoshta një kartolinë me një fotografi të bukur, ose një nevojë të caktuar personale apo një kryq të vogël druri. “Shpresoj që të mos vijë asnjëherë dita që Perëndia të ma kërkojë këtë”, thoshte secila prej tyre. Por Fryma nuk i linte të qeta dhe i shtynte të kishin një *javë dorëzimi*. Secila prej tyre duhej të hiqte dorë nga gjërat sekrete me të cilat ishte e lidhur. Pas asaj jave, ato shkuan që të vizitonin pronaren e shtëpisë, e cila tashmë kishte ndryshuar mendje.

Bazelia Shlink tha se kjo përvojë iu dha atyre një mësim rreth faljes solidarizuese, si edhe u mësoi që njerëzit nuk mund të ecin përpara kur fajësojnë dikë tjetër. Njerëzit së pari duhet të merren me qëndrimet e tyre.

Që prej Kopshtit të Edenit, fajësimi është mënyra që njerëzit përdorin për të shmangur përballjen ose ballafaqimin me përgjegjësitë e tyre. Fajësimi gjen gabimin, ndërsa falja gjen kurën. Faji ju bën viktimë, ndërsa falja ju bën fitimtar. Mungesa e faljes mund të shkaktojë probleme të tjera, përfshirë këtu sëmundjen (Jakobi 5:16) apo qëndrimin e vazhdueshëm në mëkat (Marku 11:25).

E ndjera Catherine Marshall, në autobiografinë e saj me titull “Diçka më shumë” (*Something More*), tregon historinë e Lindës, thjeshtërës së saj.

Katerina u martua me babanë e ve të Lindës kur kjo e fundit ishte vetëm 12 vjeç. Në vitet e para të adoleshencës, sjellja dhe notat e Lindës patën luhata të mëdha. Pasi la gjimnazin, ajo iu bashkua brezit rebel të viteve 1960. Me gjithë përpjekjet e saj, Katerina nuk ia doli dot mbanë që të ndërtonte një marrëdhënie të ngrohtë me thjeshtërën e saj.

Një ditë, Katerina po lexonte fjalët e Jezusit në Bibël ku Ai flet për gjërat, çfarëdo qofshin ato, që kemi kundër të tjerëve. Ajo mësoi që në qoftë se ne nuk i falim gabimet e të tjerëve, atëherë Perëndia nuk do na i falë gabimet tona (Marku 11:25). Ajo e mbushi ditarin e saj me tri faqe shënime, duke shkruar gabimet specifike të Lindës dhe e fali secilin prej tyre. Për punë javësh, qëndrimi i Lindës karshi njerëzve së saj filloi të ndryshonte rrënjësisht. Katerina kishte marrë një mësim të fuqishëm nga Jezusi: Ne nuk duhet t'i mbajmë mend gabimet e të tjerëve.

Kur ishte në kryq, Jezusi nuk i shtrëngoi grushtet e tij të shpuara nga gozhdët e të bërtiste: “Keni për të ma paguar për këtë”. Përkundrazi, ai i hapi duart dhe tha: “O Atë, fali”.

FAJËSIMI JU BËN VIKTIMË, FALJA JU BËN FITIMTAR

Një i mbijetuar nga një kamp përqendrimi ka thënë: “Zemra ime është kaq e hidhëruar saqë nëse do të ma hapnit kraharorin dhe do ta lëpinin zemrën time do të vdisnit të helmuar”. Po zemra juaj si duket?

Dikush ka thënë që të marrësh hak ndaj personit për lëndimin që të ka shkaktuar, është njësoj si ta gjuash me kaktus. Kur ta godasë kaktusi, ai do të lëndohet; por edhe ju do të lëndoni duart në proces e sipër.

SI TË FALIM

Mosfalja ka një çmim shumë të lartë, por si të kalojmë në falje? Më lejoni t'ju sugjeroj gjashtë hapa.

Së pari, rivlerësoni

Disa vite më parë po shikoja një dokumentar moti-vues, i cili kishte filmuar një eksperiment shkencor që po i bëhej një lloji peshku të ujërave të ftohta që gjendet në qendër dhe në veri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shkencëtari e kishte vendosur peshkun në një akvarium prej xhami të mbushur me ujë dhe nuk i jepte ushqim. Më pas, ai vendosi në qendër të akvariumit një cilindër prej qelqi që kishte brenda ushqimin e preferuar të këtij peshku, pra, një lloj peshku të vogël si cironkë.

Peshku i madh nuk e dallonte dot qelqin që e pengonte të arrinte ushqimin e tij. Ai bënte prapa dhe merrte vrull për të kapur prenë e tij. Por, përplasej fort pas xhamit sa herë që e tentonte këtë gjë.

Pas shumë përpjekjesh të pasuksesshme, më në fund ai hoqi dorë. Pastaj, shkencëtari e hoqi cilindrin prej qelqi dhe cironkat e vogla filluan të notonin nëpër akvarium, madje edhe poshtë hundës së peshkut të madh. Ai nuk lëvizi fare, por qëndroi i qetë dhe i mposhtur, dhe ngordhi. Pra, ngordhi sepse nuk e rivlerësoi situatën që kishte ndryshuar.

E njëjta gjë mund t'u ndodhë edhe njerëzve. Ata lëndohen dhe pastaj e kanë të vështirë të besojnë përsëri. Kjo është e kuptueshme. Megjithatë, rivlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm në rrugëtimin tonë të jetës. Në qoftë se apostulli Pal nuk do ta kishte rivlerësuar Gjon Markun, ne nuk do të kishim ungjillin e dytë.

Së dyti, pendohuni

Predikuesi i njohur Clarence Macartney tregonte këtë histori rreth Leonardo Da Vinçit. Vetë historia mund të mos jetë e vërtetë, por ajo e ilustron thelbin në mënyrë të shkëlqyer.



Pak para se Da Vinçi të fillonte punën me afreskun e tij të famshëm “Darka e Fundit”, ai bëri një goxha sherr me një mikun e tij piktor. Kaq shumë u inatos dhe u hidhërua prej tij, sa që vendosi që kur të pikturonte Judën, fytyrën e tij do ta modelonte sipas fytyrës së armikut të vet. Në këtë mënyrë do të merrte hakun, duke qenë se brezat e ardhshëm do ta shihnin fytyrën e Judës me përçmim dhe me përbuzje. Fytyra e Judës ishte e para që ai përfundoi, dhe të gjithë e dallonin lehtësisht se ajo ishte fytyra e piktorit me të cilin ishte grindur.

Fytyra e fundit që i duhej të pikturonte, ishte ajo e Krishtit; megjithatë, aty nuk po përparonte fare. Diçka e pengonte, e frenonte dhe ia prishte përpjekjet e tij më të mira.

Dhe doli në përfundimin se e vetmja gjë që po e pengonte ishte fakti se kishte përdorur fytyrën e armikut të tij në vend të fytyrës së Judës. Ai mori penelin dhe i dha Judës një fytyrë të re. Dhe pastaj, me lehtësi, përfundoi edhe fytyrën e Krishtit.

Askush nuk mund të pikturojë tiparet e Krishtit në jetën e vet, ndërkohë që e pikturon fytyrën e dikujt tjetër me ngjyrat e armiqësisë dhe të urrejtjes.

Pendim do të thotë të ndryshosh mendjen. Disa e quajnë *pendimin* fjalën e parë të ungjillit, për shkak se ky ishte mesazhi i Gjon Pagëzorit (Mateu 3:2), i Jezusit (Mateu 4:17), i të Dymbëdhjetëve (Marku 6:12), i Jezusit pas ringjalljes së tij (Luka 24:47), i Pjetrit (Veprat e Apostujve 2:38) dhe i Palit (Veprat e Apostujve 26:20).

Pendimi është i njëanshëm. Kësisoj, nuk pret që të pendohet personi tjetër i pari.

Për më tepër, pendimi nuk ka të bëjë me ndjenjat e dikujt. Por ka të bëjë me një ndryshim në mendësi që na çon në një sjellje të ndryshuar. Në Predikimin mbi Mal, Jezusi përshkruan mënyrën se si duhet ta trajtojmë armikun tonë: Duke e bekuar atë, duke bërë më shumë, duke kthyer faqen tjetër, duke u lutur për të dhe duke e falur. Në asnjë prej këtyre veprimeve nuk i kërkohet armikut tonë që të bëjë diçka. Të gjitha këto i adresohen sjelljes sonë.

Në rast se personi pret derisa të ketë ndjenjat e duhura, ai mund të mos falë asnjëherë. Zoti na bën thirrje që të pendohemi, në qoftë se kemi ndonjë qëndrim që është ndryshe nga qëndrimi i tij.

Së treti, shpengoni

Goldi Bristol ka shkruar një libër të titulluar “Këta lot janë për Dianën” (*These Tears Are for Diane*). Një burrë përdhunoi dhe vrau vajzën 21 vjeçare të Goldit. Policia e gjeti kush e bëri dhe juria e dënoi me dy dënime të përjetshme.

Pas rreth pesë vitesh, Goldi dhe Bobi, bashkëshorti i saj, dolën në përfundimin: “Nuk shohim asnjë qëllim tjetër se pse ky burrë erdhi në jetën tonë nëse nuk ekziston një mundësi që ai të shpëtohet”.

Dhe kështu, i shkruan një letër, jo për t’ia harruar krimin, por për të shprehur shqetësimin e tyre dhe të Perëndisë për të. Pas dy letrave të tjera, ata morën një përgjigje. Personi kishte thënë se nuk e kishte kuptuar se kishte njerëz në këtë botë që e vendosnin shqetësimin për të mbi lëndimin e tyre.

“Ç’dobi mund të ketë urrejtja?”, pyeti Goldi. Urrëjtja nuk mund t’ia kthente asaj vajzën; vetëm sa do ta përhapte helmin e zemërimit dhe të mosfaljes në jetën e saj, dhe nuk do të kishte asnjë lloj ndikimi tek vrasësi i vajzës së saj.

Në libër, ajo shkruan: “Fjalori e lidh inatin me keqdashjen, e cila të gërryen, të konsumon dhe në fund të shkatërron. Nëse e lejoj atë të marrë kontroll mbi jetën time, vetëm e lirë që nuk mund të quhem. Pikërisht mjeti që do të përdorja për të marrë hak, do të ishte ai që do të më lidhte me zinxhirë.

Perëndia është i vetmi që është në gjendje ta menaxhojë këtë lloj pabesie në jetët tona dhe të na çlirojë nga ky kurth. Prandaj, vendimi është i imi. Ose mund ta mbart zemërimin, mosfaljen dhe fyerjen me vete kudo që shkoj, dhe të thyhem nga pesha e saj, ose t’ia dorëzoj Atit tim qiellor, i cili mund ta mbajë peshën e tyre të rëndë”.

Fjalët e Goldit nuk janë të reja. Stefani e njihte mirë fuqinë e faljes shpenguese kur “ra në gjunjë, thirri me zë të lartë: ‘O Zot, mos ua ngarko atyre këtë mëkat!’” (Veprat e Apostujve 7:60). Si përfundim, lutja e Stefanit rezultoi në konvertimin e Saulit.

Së katërti, përsëriteni

Jezusi na tha që të falim shtatëdhjetë herë shtatë (Mateu 18:22). Këtë gjë nëna ime ma mësoi që kur isha një djalë i vogël. Ajo më tha që kur fëmijët e tjerë të më ngacmonin, t’u ktheja faqen tjetër.

Një nga bullistët e vegjël m’u bë rrodhe. Ai vazhdimisht më gjuante, më ofendonte dhe përpiquej të zihej me mua. Një ditë, nëna ime vuri re se po vizatoja ca vija mbi një copë letre. Duke iu përgjigjur pyetjeve të saj, i thashë se sa herë që Billi më ngacmonte, unë shtoja një vijë në letër. Kur të arrija 491 vija, atëherë Jezusi më kishte dhënë leje që ta gjuaja edhe unë.

Kushedi sa shumë është lutur nëna ime, sepse pas disa ditësh Billi na tha se ai dhe prindërit e tij po shpërnguleshin. Deri atëherë llogaritë e mia kishin shkuar në rreth 250.

I kisha parë fjalët e Jezusit nga një pikëpamje feminare. Nuk e kuptoja se 70 herë 7 ishte mënyra e Jezusit për të përshkruar idenë se ne duhet të falim pafund.

Nëse Zoti na tha ta falim njëri-tjetrin 70 herë 7, e dimë se ai bën të njëjtën gjë edhe shumë më tepër. Jezusi tha se të krishterëve mund t'u duhet vazhdimisht që të falin dikë. Kjo nuk do të thotë që t'i lejojmë të tjerët të abuzojnë dhe të na hipin në qafë. Falja nuk i jep leje askujt që të vazhdojë të na lëndojë. Ndoshta mund të kërkohet që të ketë hapësirë, por zemrat tona mund të qëndrojnë të buta. Kur ne falim, mund të mos e harrojmë të shkuarën, megjithatë, në qoftë se e qëmtojmë atë vazhdimisht, kjo nuk na sjell asnjë dobi.

Së pesti, mos harroni, hiri paguan faturën

Në qoftë se vij për vizitë në shtëpinë tuaj dhe thyej diçka të shtrenjtë dhe ju më falni, ju po më çlironi nga detyrimi për të paguar shumën për të mbuluar koston. (Gjithsesi, një person i njerëzishëm dhe me edukatë, do të ofronte të paguante për dëmin).

Kur dikush fal, ai po paguan çmimin për keqbërjen. Kjo është ajo që Jezusi bëri për ne në kryq. Ai pagoi borxhin tonë, një borxh për të cilin ai nuk na detyrohej.

Personi që fal është më i fortë se ai që shkaktoi lëndimin, sepse duhet më shumë forcë për të falur, sesa duhet për të lënduar. Për t'iu bashkuar Krishtit në punën e pajtimit, na duhet të jemi njerëz të hirshëm.

Së gjashti, shkoni te Perëndia për të kërkuar ndihmë

Nuk është e lehtë të falim.

Le të marrim në konsideratë historinë e Davidit dhe të Absalomit te Libri i Dytë i Samuelit 13 - 18. Amnoni, vëllai i Absalomit, përdhunoi Tamarën, motrën e Absalomit. Ky pastaj e vrau Amnonin dhe u arratis. Tre vjet më vonë, Davidi e rikthehu birin e tij në Jerusalem, por refuzoi ta shihte atë për dy vjet.

Gabimi që bëri Davidi ishte falja e paplotë. Krahasoni Davidin me atin e djalit plëngprishës (Luka 15:11-32). Ky baba vrapoi për tek biri i tij, e puthi, e veshi, theri viçin e majmë, bëri festë për të dhe e mbrojti.

Cilin shembull do të ndiqni ju me personin që ju ka lënduar? Ka raste kur, nga pikëpamja njerëzore, një person e ka të pamundur të falë. Pavarësisht se

sa mirë e di personi se falja është gjëja e duhur dhe është biblike, ai nuk mund ta bëjë. Lëndimi është shumë i thellë; plaga ende acarohet.

Ndoshta ky shembull ju ndihmon. Kori ten Bum (Corrie ten Boom) e mbyll librin e saj "Vendi i fshehtë" (The Hiding Place) me historinë kur ishte duke folur në një kishë në Munih pas Luftës së Dytë Botërore. Në shërbesë ishte i pranishëm edhe një pjesëtar i SS-ve gjermanë, i cili kishte qenë gardian i derës së dushit në qendrën e përpunimit në kampin e përqendrimit të Ravensbruket. Kur Kori e pa këtë njeri, papritur asaj iu kujtua dhoma e mbushur plot me burra që e tallnin, përgjethur e rrobave dhe fytyra e zverdhur nga dhimbjet e Betsit, motrës së saj. Ndërkohë që kisha po zbrazej, ai iu afrua Korit, me një fytyrë të çelur dhe duke u përkulur. "Fraulajn" (gjer. zonjushë), tha ai, "të mendosh që, siç thatë edhe ju, ai m'i ka larë mëkatet".

Ai nxori dorën për t'ia dhënë Korit, por ajo, edhe pse u kishte folur të tjerëve në lidhje me nevojën për të falur, e mbajti dorën të ulur. Ndërkohë që po luftonte përbrenda me zemërimin e saj, ajo u lut: "O Zot, më fal dhe më ndihmo ta fal atë". Ajo u përpoq të buzëqeshte dhe u mundua të ngrinte dorën, por nuk ia arriti. Dhe përsëri u lut: "O Jezus, unë nuk mund ta fal këtë njeri. Më jep faljen tënde". Në libër, ajo shkruan: "Kur ia dhashë dorën atij, diçka shumë e jashtëzakonshme ndodhi. M'u duk sikur ishte një rrymë që kalonte tek ai nga supi im, përgjatë krahut dhe përmes dorës, ndërkohë që në zemrën time buroi një dashuri për këtë të panjohur që pothuajse më mbuloi të tërën. Dhe kështu, zbulova se shërimi në botë nuk varej nga falja jonë, e aq më pak nga mirësia jonë, por nga falja dhe mirësia e Tij. Kur ai na thotë të duam armiq të tanë, bashkë me urdhërimin, ai na jep edhe forcën".

PËR T'U MENDUAR

Mendoni përsëri për personin apo personat që ju kanë lënduar. Kush janë ata? A do t'i falni apo nuk do t'i falni?

Vendosni këshillën e apostullit Pal në zemrën tuaj: "Por jini të mirë dhe të përdëlllyeshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin" (Efes. 4:32).



GEORGE O. WOOD, D.Th.P.,

është ish mbikëqyrësi i përgjithshëm për Këshillin e Përgjithshëm të Asambleve të Perëndisë në qytetin Springfield, Missouri.

IMPACT KOSOVA

Nga: **KURT PLAGENHOEF**

Perëndia na ka dhënë një vizion për të arritur Ballkanin me lajmin e mirë të Krishtit, dhe pjesë e këtij plani është edhe Kosova. Përpara luftës së vitit 1999, në Kosovë kishte vetëm 6 kisha ungjillore dhe rreth 150 besimtarë. Sot numërohen rreth 25 kisha ungjillore dhe 1,500 besimtarë. Lavdi Zotit! Ky është një hap përpara, por është ende fillimi për ta arritur këtë komb në mënyrë efikase.

Javën e 9 korrikut, një skuadër e përbërë nga 32 persona nga Asambletë e Perëndisë në Shqipëri mori pjesë në fushatën *Ndiko Kosovën (Impact Kosovo) 2018*. Kjo fushatë ungjillëzimi ishte organizuar nga Bashkësia Pentekostale Europiane (PEF - Pentecostal European Fellowship). Skuadra jonë iu bashkua 300 personave të tjerë nga të paktën shtatë vende të ndryshme, për ta çuar në Kosovë lajmin e mirë të Jezusit. Ditën e parë të fushatës, të gjithë u mbledhëm në sheshin kryesor të Prishtinës ku organizuam një kërcim me hapa dhe lëvizje. Aty kënduam dhe kërcyem, duke shpallur me guxim dhe publikisht që: "Jezusi është i gjallë!". Pati mjaft njerëz që ndaluan në shesh për të parë dhe për të dëgjuar se ç'po ndodhte. Pas kërcimit, ne u shpërndamë nëpër lagje të ndryshme të Prishtinës duke ungjillëzuar përmes dramave, këngëve dhe dëshmive. Përmes dëshmisë së skuadrës sonë, dy vajza u prekën nga Lajmi i Mirë dhe u lutën për shpëtimin e tyre. Lavdi Zotit!

Nga Prishtina u dërguam në disa qytete të Kosovës për të shërbyer. Skuadra jonë nga Shqipëria shërbeu tek Qendra "Shpresa" në Mitrovicë. Puna për këtë qendër në Mitrovicë ka nisur që pas luftës së vitit 1999. Në një qytet me rreth 80 mijë banorë, me mijëra njerëz kanë dëgjuar ungjillin dhe janë prekur nga dashuria e Perëndisë, por janë vetëm pesë besimtarë që e kanë pranuar hapur besimin e tyre. Në këtë kontekst, duhet të kesh goxha guxim dhe besim për të pranuar Krishtin. Dy nga mbrëmjet që ishim aty, na u bashkuan edhe disa





skuadra nga Finlanda dhe vende të tjera të Europës. Rreth shtatëdhjetë vetë nga tanët ecën nëpër qendrën e qytetit duke mbajtur veshur bluzat e kuqe me mbishkrimin "Impact Kosova". Kjo gjë nuk është bërë kurrë më parë në Mitrovicë. Dhe përsëri, përdorëm dramën, këngët dhe dëshmitë për të kapur vëmendjen e njerëzve dhe për të ndarë me ta historitë e fuqisë shpëtuese të Jezusit. U angazhuam në biseda me njerëz të ndryshëm dhe pamë që njerëzit ishin të hapur për të dëgjuar ungjillin, gjë që nuk është parë asnjëherë atje. Ndërkohë që u lutëm për njerëzit, ndjemë pasionin dhe fuqinë e Perëndisë teksa rridhte në atë vend. Shumë prej tyre u prekën, duke përfshirë këtu edhe dy studentë, një nënë me tri vajza dhe dy burra të cilët morën nga një Bibël. Lutuni që ata do ta pranojnë Jezusin si Shpëtimtarin dhe Zotin e tyre!

Vazhdoni të luteni që pengesat frymërore dhe sociale të shemben dhe që kisha në Mitrovicë të rritet. Kërkojini Perëndisë që të ngrejë shqiptarë, të cilët do të shërbejnë dhe do të mishërojnë ungjillin. Stiv dhe Lisa Fraj (Frey), që janë drejtuesit e punës në Mitrovicë, po vazhdojnë komunikimin me kontaktet që krijuam dhe po besojnë se ata do të vijnë te Krishti. Është një punë e madhe dhe e vështirë, por Jezusi do ta ndërtojë kishën e tij në Mitrovicë, dhe ne dëshirojmë të ndihmojmë duke bërë pjesën tonë.

Të dashur pastorë, dëshiroj t'ju inkurajoj që të dërgoni njerëz nga kishat tuaja për t'u bërë pjesë e këtyre ngjarjeve të veçanta ungjillëzuese. Kur njerëzit tuaj marrin pjesë në mision, ata shohin nevojën e personave të humbur dhe të paarritur, dhe kthehen të mbushur me zjarrin e Perëndisë në zemrat e tyre, të gatshëm për ta ndarë zellin e tyre me kishën vendore. Ata përhapin vizionin, i cili gjithashtu mund të jetë ndihmë për të ndërtuar dhe frymëzuar kishën vendore në kontekstin e saj brenda komunitetit. Ky është një investim i mirë për mbretërinë e Perëndisë, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Zoti na dhëntë shpirtin, ndërkohë që lutemi dhe ndajmë ungjillin me ata që ende nuk e kanë dëgjuar atë!





FUNDJAVA PASTORALE

*Për të gjithë pastorët e Asambleve të Perëndisë
dhe gratë e fëmijët e tyre.*

FUQIZIMI

*“Në dorën tënde janë forca dhe fuqia,
dhe ti ke fuqinë për të bërë të madh dhe për t’u dhënë forcë të gjithëve.”*

28-30 shtator 2018, 3:00 pasdite, të premte – 4:00 pasdite, të dielë

Hotel Milenium
Tushemisht, Pogradec



Konferenca Kombëtare BURRAVE 2018




13 tetor
të premten
14⁰⁰-20⁰⁰

VENDI: KOLEGJI TEOLGJIK UNGJILLOR

BURRA TË PERËNDISHËM NË MES TË NJË BREZI TË PAPERËNDISHËM

Inkurajimi dhe fuqizimi i burrave që të jetojnë për Krishtin në familjet dhe kishat e tyre duke pasur një rol më aktiv dhe bashkësi vëllazërore.

- Dy mesazhe frymëzuese mbi të jetuarit si burra të perëndishëm
- Lutje për pagëzim me Frymën dhe fuqizim
- Grupe lutjeje & workshops
- Darkë dhe bashkësi me njëri tjetrin



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

*...sepse Perëndia i të Korrave vazhdon
të thërrasë punëtorë!*



Në KTU, bashkëpunëtorët tuaj të ardhshëm...

- do të rriten si udhëheqës shërbëtorë të fuqizuar nga Fryma e Shenjtë, dhe do të sfidohen për të zhvilluar një karakter të perëndishëm
- do të studiojnë në mënyrë të disiplinuar Biblën, teologjinë, dhe shërbesat e kishës, në një kontekst pentekostal.
- do të kenë mundësinë t'i përgjigjen thirrjes së Perëndisë dhe të, trainohen si pastorë, kishëmbjellës, misionarë apo në shërbesa të tjera, në brezin pasardhës të drejtuesve të kishës.



Për më shumë informacion, kontaktoni:

KTUShqiperi@gmail.com ♦ Cel.: 069 406 8956